

LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJËRAT E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR UJËRAT E KOSOVËS

KREU I

**Neni 1
Qëllimi**

1. Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

2.1. të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës;

2.2. të themelojë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin;

2.3. të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi;

2.4. të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin e resurseve ujore.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Me këtë ligj rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat.

**Neni 3
Qasja në informata**

Rregullon çështjet që kanë të bëjnë me: qasjen në informata që lidhen me ujërat, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes që ka të bëjë me menaxhimin e ujërave, vlerësimin e ndikimit nga strategjitë e ndryshme, planet dhe programet mbi mjedisin, vlerësimin e ndikimeve nga projektet e caktuara, pengimin dhe kontrollin e avarive me praninë e materieve të rrezikshme, lejet e integruara ekologjike për punë dhe instalime që ndikojnë në mjedisin ujor.

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Administrim i ujërave** - tërësia e aktiviteteve, vendimeve dhe masave lidhur me ujërat, të planifikuara dhe zbatuara, me qëllim të arritjes së objektivave për zhvillimin e resurseve ujore.

1.2. **Akt nënligjor** - aktet e nxjerra nga Ministria apo Qeveria, përfshirë udhëzimet administrative, rregulloret, vendimet etj.

1.3. **Autoriteti kompetent** – është autoriteti ose autoritete të identifikuara sipas kreut II dhe III të këtij ligji.

1.4. **Breg** - toka që puqet me liqenet, lumenjtë, rezervuaret dhe ujërrjedhat e cila ndikon apo ndikohet nga këta trupa ujorë.

1.5. **E drejta ujore** - lejet ujore dhe koncesionet për ujëra.

1.6. **Efekt i dëmshëm i ujërave** - veprimet e ujit të cilat dëmtojnë pronën dhe paraqesin rrezik për njeriun.

1.7. **Erozion** - shkatërrim i shkëmbinjve nga veprimtaria e ujërave, që sjell thellimin apo zgjerimin e shtratit të rrjedhës.

1.8. **Objektet dhe pajisjet** - infrastruktura që nevojitet për administrimin dhe menaxhimin e ujërave.

1.9. **Koncesioni** - formë kontrate me shkrim, me të cilën autoritetet kompetente lejojnë bartësin e koncesionit, të gëzojë ndonjë të drejtë ekskluzive për nxjerrjen, shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave, sipas kushteve të koncesionit.

1.10. **Gjendja kimike e mirë e ujërave sipërfaqësorë** - gjendja kimike e nevojshme për të plotësuar objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësorë dhe nuk tejkalon standardet e cilësisë mjedisore.

1.11. **Gjendja kimike e mirë e ujërave nëntokësorë** - gjendja e një mase të ujërave nëntokësorë, e cila i plotëson të gjitha kushtet e objektivat mjedisore për ujërat nëntokësorë dhe nuk tejkalon standardet e cilësisë mjedisore për ujëra nëntokësorë.

1.12. **Leje ujore** - e drejtë e dhënë me shkrim nga institucionet e përcaktuara me këtë ligj për të përdorur apo shkarkuar një sasi uji për një qëllim dhe kohë të caktuar.

1.13. **Lumë** - një masë rrjedhëse ujërash të brendshme, në pjesën më të madhe mbi sipërfaqen e truallit, por mund të rrjedhë dhe në pjesën nëntokësore të shtresës së tij.

1.14. **Liqe** - një masë ujërash sipërfaqësorë të brendshme, të ndenjura.

1.15. **Materie të rrezikshme** - substanca apo grup substancash helmuese që janë të qëndrueshme dhe substancat me veti bioakumuluese apo grupet e substancave të cilat shkaktojnë nivel të njëjtë të rrezikut.

1.16. **Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave** - ndërmarrja e aktiviteteve apo masave të zbatuara për parandalimin ose zbutjen e efekteve të dëmshme të ujërave.

1.17. **Ministria** - Ministrinë përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

1.18. **Ministri** - Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

1.19. **Ndotja** - rezultat i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i aktiviteteve njerëzore, substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë apo tokë që mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut ose kualitetin e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që drejtpërdrejt varen nga sistemet ujore të cilat rezultojnë në dëmtimin e pronës, keqësojnë ose ndërhyjnë në rekreacion dhe përdorime të tjera të mjedisit.

1.20. **Ndotës** - çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje.

1.21. **Nxjerrje** - lëvizje e ujërave kohë pas kohe nga trupi ujqor sipërfaqësor me qëllim të krijimit të rezervave dhe përdorimit të tyre.

1.22. **Pellg ujqor** - sipërfaqja e tokës nga e cila e gjithë sipërfaqja e derdhjes rrjedh përmes një sekuence të rrymave, lumenjve dhe mundësisht liqeneve për në det sipas një grykëderdhje të vetme, grykëderdhje të gjerë ose deltë.

1.23. **Pellg lumi** - sipërfaqja e tokës nga e cila të gjitha rrjedhat sipërfaqësore, derdhen përmes rrekeve, lumenjve ose liqeneve në det, grykëderdhje apo deltë.

1.24. **Nën pellg** - sipërfaqja e tokës nga e cila gjithë sipërfaqja e derdhjes rrjedh përmes një serie rrymash, lumenjsh dhe, mundësisht liqenesh tek një pikë e veçantë në një shtresë uji - normalisht një liqen ose një bashkërrjedhje lumore.

1.25. **Përdorim i ujqit** - shërbimet e ujqit së bashku me aktivitetet tjera të ofrimit të shërbimit me ujë.

1.26. **Person** - person fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat.

1.27. **Resurs ujqor** - të gjithë ujërat e brendshëm sipërfaqësor dhe nëntokësor, akuiferat dhe reshjet atmosferike, përfshirë edhe tokat ujqore.

1.28. **Regjim i ujërave** - është tërësia e parametrave të cilët e përcaktojnë gjendjen sasiore dhe cilësore të ujërave, në vendin dhe në kohën e caktuar, përfshirë: niveli e ujqit, rrjedha, drejtimin dhe shpejtësinë e rrjedhjes, vetitë fizike, kimike dhe radioaktive, përbërjen biologjike, prurjet e aluvioneve dhe parametrat tjerë.

1.29. **Prurja e pranueshme ekologjike** - paraqet prurjen minimale e cila siguron ekuilibrin natyror dhe ekosistemin lidhur me ujqin.

1.30. **Urdhëresa ujqore** – akt për administrimin dhe menaxhimin e resurseve ujqore në periudhën e validitetit të lejës ujqore.

1.31. **Kushte ujqore** – akt i përcaktimit të kushteve dhe përbërjes së dokumentacionit për ndërtimin e objekteve të reja dhe rikonstruimin e objekteve ekzistuese, për ndrrimin e teknologjisë dhe punëve tjera të cilat nuk trajtohen si ndërtime, të cilat përkohësisht ose periodikisht mund të ndikojnë në regjimin e ujërave.

1.32. **Pëlqimi ujqor** – akt i përcaktimit dhe harmonizimit të dokumentacionit që i bashkangjitet kërkesës për lëshimin e pëlqimit ujqor me kushtet ujqore, legjisllacionin e ujërave dhe dokumentet planifikuese.

1.33. **Regjim ujq** - kompleks i veqorive natyrore apo artificiale hidrologjike, hidromorfologjike dhe hidraulike tē ujērave sipërfaqēsorē dhe nēntokēsorē tē njē zone specifike gjatē njē periudhe kohore.

1.34. **Rajon i pellgut lumor** - sipërfaqe e tokēs, e krijuar nga njē apo mē shumē pellgje lumenjsh fqinjē bashkē me ujērat nēntokēsorē qē ēshtē identifikuar me kētē ligj si njēsi pēr menaxhimin e pellgut lumor.

1.35. **Retenzion** - mabajtja e pērkohshme e ujit tē rreshjeve nē kontinent - rezervuar, liqe.

1.36. **Rrēke** - rrymē ujore tē krijuara gjatē tē rreshurave nē shpatet malore.

1.37. **Substanca prioritare** - substanca tē identifikuar nē pērputhje me legjislacionin mjedisor nē fuqi dhe direktivēn kornizē pēr ujēra 2000/60.

1.38. **Shfrytēzimi i ujit** -shērbimet dhe aktivitet tē tjera qē mund tē kenē ndikim tē veqantē nē gjendjen dhe regjimin e ujērave.

1.39. **Shkarkim** - lēshim i ujērave tē ndotura tē trajtuara apo tē patrajtuara tē ujērave tē pērdorura, tē kanalizimit, produkteve kimike dhe nēnprodukteve, mbeturinave industriale dhe substancave, pa marrē parasysht natyrēn e tyre, nē ujērat sipërfaqēsorē dhe nēntokēsorē, sipërfaqe tokēsore, nēn tokē apo vende tē gērmuara

1.40. **Shtrat** - luginē natyrore, nēpēr tē cilēn pērherē ose kohē pas kohe, rrjedh uji ose nē tē cilēn qēndrojnë trupat ujq amull.

1.41. **Trup ujq artificial** - trupi sipërfaqēsor i krijuar nga aktivitetet njerēzore.

1.42. **Trup ujq sipërfaqēsor** - elemente diskrete dhe kuptimplote tē ujērave sipërfaqēsor si liqenet, akumulimet, ujērrjedhat dhe kanalet.

1.43. **Ujērat e brendshme** - tē gjitha ujērat e ndenjura ose ujērat e rrjedhshme mbi sipërfaqen e njē terreni dhe gjithē ujērat nēntokēsorē nē drejtim tē bazamentit tē tokēs mbi tē cilēn ēshtē matur gjerēsia territoriale e ujērave.

1.44. **Ujēra nēntokēsorē** - tē gjitha ujērat tē cilat janē nēn sipërfaqen e tokēs nē zonēn ujēmbajtēse dhe nē kontakt direkt me tokēn ose tabanin.

1.45. **Ujērat sipërfaqēsorē** - ujērat e brendshme, pērveq ujit nēntokēsor, ujērat e pērkohshme dhe ujērat bregdetare, me pērjashtim tē statusit kimik pēr tē cilin ai duhet tē pērshijē gjithashtu ujērat territoriale.

1.46. **Zonē e rrezikuar nga erozioni** - zona e cila nga veprimet e ujit apo erēs vjen deri te shpēlarja, gērryerja ose rrēshqitja e tokēs si dhe veprimet e tjera tē dēmshme tē cilat rrezikojnē shēndetin publik, pasurinē e tyre dhe çrregullimin e regjimit ujq dhe planifikimit hapēsitor.

1.47. **IKSHP** - Instituti Kombētar i Shēndetit Publik.

1.48. **IHMK** - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovēs.

Neni 5 Zbatimi

1. Administrimi me ujēra ēshtē veprimtari me interes shtetēror qē kryhet nē pajtim me dispozitat e kētij ligji.

2. Me zbatimin e masave të parapara me këtë ligj nuk lejohet përkeqësimi i gjendjes së ujërave.

3. Të gjitha masat, standardet nga fusha e ujërave dhe qëllimet e mbrojtjes së mjedisit, zbatohen si kërkesa minimale që duhet të plotësohen gjatë administrimit dhe menaxhimit me ujëra.

Neni 6

Parimet për administrim të qëndrueshëm

1. Në pajtim me qëllimet për mbrojtjen, ruajtjen, shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë, administrimi me ujëra bazohet në:

1.1. **Konceptin ekologjik, social dhe ekonomik** - ujërat janë pjesë e proceseve natyrore dhe duhet të mbrohen si vendbanime të florës dhe faunës dhe me menaxhimin e tyre sigurohet interesi publik, i përcaktuar me ligj;

1.2. **Parimin e përkujdesjes** - nëse ekziston rreziku se aktiviteti i caktuar mund të shkaktojë veprim të dëmshëm në ujërat ose veprim të dëmshëm nga ujërat, por për të nuk ka dëshmi shkencore, ndërmerren masa të bazuara në vlerësimin përkatës të rrezikut, të domosdoshme që të sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së ujërave dhe nga ujërat;

1.3. **Parimin e parandalimit** - masat dhe aktivitetet e domosdoshme për mbrojtjen e ujërave dhe për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave duhet të ndërmerren në fazën e hershme, duke e penguar që të paraqitet rreziku ose të vijë te çfarëdo pasojë e dëmshme për ujërat;

1.4. **Parimin e minimizimit të përdorimit të resurseve ujore** - që do të thotë se me rastin e aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në ujëra, çdokush ka detyrim të silltet me kujdes dhe racionalisht t'i shfrytëzojë ujërat, të pengojë ndotjen e ujërave dhe të shmang çfarëdo efekti negativ dhe rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin;

1.5. **Parimin e integritimit** - që do të thotë se gjatë administrimit me ujëra, duhet të parashikohet mundësia e lidhjes mes veti të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, raportet mes tyre dhe me ekosistemin e varur nga ujërat dhe medime të tjera në mjedis si dhe politikat e sektorëve tjerë siç janë bujqësia dhe industria të cilat duhet të marrin në konsiderim çështjet e administrimit të ujërave;

1.6. **Parimin „ ndotësi paguan”** - që do të thotë se çdo person që shkakton apo lejon shkarkime të ndotjes, do të përgjigjet financiarisht dhe penalisht, për të gjitha shpenzimet që dalin, përfshirë edhe shpenzimet për parandalimin e ndotjes, masat e nevojshme kontrolluese, shpenzimet administrative, shpenzimet riparuese apo kompensuese, në pajtim me këtë ligj;

1.7. **Parimin „ shfrytëzuesi paguan”** - që do të thotë se shfrytëzuesi i ujit, do t'i paguajë të gjitha shpenzimet të cilat dalin nga ofrimi i shërbimeve në të cilat do të jenë të përfshira edhe shpenzimet e resurseve ujore për shfrytëzim, si dhe shpenzimet për mjedisin;

1.8. **Parimin e pengimit të ndotjes** - në vendin e ndodhjes së ndotjes lëshimi i materieve dhe substancave ndotëse pengohet në vendin e ndodhjes së tyre;

1.9. **Parimin e perspektivës kohore** - afatet kohore në planet dhe në vendimet për administrimin dhe menaxhimin me resurset ujore duhet të përkohet me perspektivën kohore të efekteve të pritura;

1.10. **Parimin e pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në informata** - që do të thotë se organet kompetente detyrohen të sigurojnë qasje në informata për interesin e të gjitha palëve të interesuara me rastin e marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me resurset ujore;

1.11. **Parimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara** - organet kompetente janë të detyruara që të sigurojnë, që në procedurën për miratimin e dispozitave, dokumenteve strategjike, plan - programeve dhe vendimeve të marrin parasysh interesat e palëve të interesuara;

1.12. **Parimin universal të shërbimeve ujore** - sigurohet përmes mos diskriminimit, qëndrueshmërisë së shërbimit, cilësisë, efikasitetit, transparencës, çmimit të pranueshëm ekonomik dhe mbulimit të tërësishëm në sferën e kryerjes së shërbimeve.

Neni 7 Resurset Ujore

1. Ujërat nuk janë lëndë e së drejtës së pronësisë të personave fizikë dhe juridikë, pa dallim nga statusi juridik i pronës në të cilën gjenden.

2. Nxjerrja, shfrytëzimi, akumulimi, ndryshimi i drejtimit, ndërtimi, lëshimi si dhe veprimet tjera ndaj ujërave, kryhen në kushte, në mënyra dhe në procedura të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 8 Pasuritë ujore artificiale

1. Pasuritë ujore artificiale përfshin:

1.1. resurset ujore të cilat janë krijuar si rezultat i zhvendosjes apo rregullimit të rrjedhave natyrore ujore; dhe

1.2. marrjen e ujërave, eksplotimin e inerteve apo veprimtarive të ngjashme.

2. Pavarësisht nga nënparagrafi 1.1. i paragrafit 1. të këtij neni, resurset ujore të cilat janë formuar për qëllime të të drejtave ujore, por të cilat nuk mund të përdoren për përdorim të përgjithshëm, nuk mund të jenë pasuri ujore artificiale.

3. Në rastet, kur resurset ujore nga nënparagrafi 1.1. i paragrafit 1. të këtij neni janë në pronësi private, Ministri me vendim mund t'i shpallë pasuri ujore publike artificiale, kurse procedura e regjistrimit të hapësirës, si pasuri publike ujore, bëhet në pajtim me ligjin.

4. Statusi i pasurive ujore publike artificiale, mund të pushoj, kur nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj.

5. Ministri me akt nënligjor, do të rregulloj mënyrën e shpalljes dhe humbjes së statusit, nga paragrafi 4. i këtij neni.

Neni 9 Formimi i statusit të pasurive ujore natyrore

1. Me qëllim të mbrojtjes së ujërave, shfrytëzimit të përgjithshëm të ujit, pasurive tjera ujore të cilat kryhen për nevoja të interesit publik, pronarit ose poseduesit të tokës dhe të resurseve ujore, mund t'i kufizohet shfrytëzimi i tyre, në pajtim me ligjin.

2. Me qëllim të sigurimit të qasjes së lirë në resurset ujore, e drejta e kalimit bëhet në pajtim me ligjin.

Neni 10 Kufizimet për përdorim publik

1. Kalimi në hapësirat fizike dhe ujëra, mund të lejohet vetëm për qëllimet e ndërtimit dhe instalimit të pajisjeve të infrastrukturës publike; ndërtimit të pajisjeve për pasuritë artificiale, të parapara me këtë ligj dhe aktet nënligjore, të dalura nga ky ligj; masave të zbatuara për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike, të ujërave sipërfaqësor; masave të zbatuara për mbrojtje të natyrës;

ndërtimit të pajisjeve të nevojshme; ndërtimit të objekteve për përdorim të ujërve; mbrojtjes nga përmytjet; shfrytëzimit të banjove natyrore; dhe vendosjes së pajisjeve të caktuara, për siguri publike dhe shpëtim.

2. Pronari ose poseduesi i tokës, duhet të lejoj kalim të lirë në tokën e tij dhe pasurinë ujore dhe të lejoj përdorim publik të pasurive ujore, për qëllimet e parapara, sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Përdorimi publik i tokave, për rreth brigjeve ujore për përdorim publik, duhet të lejohet, nëse përdorimi i tillë, pronarit nuk i shkakton ndonjë dëm.

4. Pronari ose poseduesi i pajisjeve të infrastrukturës publike, duhet ta përjashtoj përdorimin publik, në zonat ku janë të vendosura pajisjet, nëse është në interes të mbrojtjes së shëndetit publik.

5. Pronari ose poseduesi i ujërave dhe resurseve ujore, nuk ka të drejtë në kompensim, për kufizimet nga paragrafi 1. i këtij neni, përveç dëmit të zakonshëm.

Neni 11 Detyrimet lidhur me kërkimet ujore

1. Për qëllime të kërkimeve ujore, për nevojat e furnizimit me ujë të pijes, vrojtimit për interes publik të ujërave, pronari ose poseduesi i tokës, është i detyruar që të lejoj personat e autorizuar të shërbimeve publike që t'i kryejnë të gjitha punët e lidhura me shërbimin publik dhe të lejojë kalim të lirë në atë zonë.

2. Pronari ose poseduesi i resurseve ujore, brigjeve apo tokës tjetër, për nevojat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni, është i detyruar të lejoj përdorimin e mjeteve dhe instalimeve të veta të cilat përdoren për marrjen e mostrave të ujit.

3. Kryesi i punëve nga paragrafi 1. i këtij neni, është i detyruar që pas kryerjes së punëve, tokën dhe objektet, t'i kthej në gjendjen e mëparshme.

4. Pronari ose poseduesi i resurseve ujore, brigjeve apo tokës tjetër, për punët e kryera sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni ka të drejtë kompensimi për dëmin e shkaktuar.

Neni 12 Ekspropriimi –shpronësimi- i pronës për përdorim publik

1. Për përdorim publik të ujërave ose të brigjeve, në raste kur është e domosdoshme, Qeveria e Kosovës “këtu e tutje: Qeveria”, mund të kërkoj ekspropriim apo kufizim të të drejtave të pronarit, përkatësisht të poseduesit të tokave, ujit apo brigjeve, në pajtim me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

2. Për ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve ujore, të destinuara për shërbime publike sipas këtij ligji, të drejtat e pronarit në resurset ujore apo brigjeve ujore, mund t'i merren, në pajtim me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

KREU II KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 13 Përgjegjësitë e Ministrisë

1. Ministria është përgjegjëse për:

1.1. hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me të gjitha çështjet e resurseve ujore në Republikën e Kosovës;

1.2. zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fusha e resurseve ujore, përfshirë edhe ligjet tjera nga fusha e mjedisit jetësor;

1.3. zhvillimin e politikave nga fusha e resurseve ujore, si dhe objektivave nga programi i Qeverisë për fushën e resurseve ujore dhe mjedisit;

1.4. hartimin e Strategjisë Shtetërore për resurse ujore dhe Planeve për menaxhimin e resurseve ujore në nivel pellgu lumor;

1.5. administrimin dhe menaxhimin e të gjitha resurset ujore në territorin e Republikës së Kosovës;

1.6. kryerjen e të gjitha punëve dhe aktiviteteve administrative, profesionale dhe punëve tjera organizative dhe zhvillimore që obligohen me këtë ligj;

1.7. bashkëpunimin e ngushtë me ministritë tjera të linjës në Republikën e Kosovës lidhur me resurset ujore dhe mjedisin jetësor;

1.8. bashkëpunimin ndërkufitar me shtetet fqinje dhe më gjerë në fushën e resurseve ujore.

Neni 14 Komunat

1. Komuna është përgjegjëse për lëshimin e lejeve ujore të përcaktuar sipas aktit nënligjor për leje ujore.
2. Komuna është përgjegjëse edhe sipas neneve 40, 46, 47, 49, 51, 55, 57, 68 dhe 72 të këtij ligji.

KREU III ORGANET DHE NJËSIT QË THEMLOHEN ME LIGJIN E UJËRAVE

Neni 15 Këshilli ndërministror për ujërat

1. Me këtë ligj themelohet Këshilli ndërministror për ujërat.
2. Këshilli ndërministror është trup koordinues dhe vendimmarrës, që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës.

Neni 16 Përbërja e Këshillit

1. Këshilli ndërministror për ujëra përbëhet nga pesë (5) anëtarë.
2. Anëtarët e Këshillit ndërministror për ujëra janë Kryeministri i Kosovës dhe katër (4) ministra të linjës. Këshilli udhëhiqet nga kryeministri i Kosovës.

Neni 17 Funksioni

1. Këshilli ndërministror për ujëra jep mendime dhe rekomandime për:
 - 1.1. propozim ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;

1.2. zbatimin e ligjeve dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;

1.3. hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetërore për ujëra;

1.4. zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;

1.5. zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave.

Neni 18

Rregullorja dhe kryerja e punëve administrativo - teknike

1. Këshilli ndërministror i ujërave harton rregulloren e punës të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. Mjetet për shpenzimet e punës së këshillit ndërministror të ujërave sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 19

Raportimi

Këshilli ndërministror i ujërave përgatitë raporte vjetore të cilat i raporton para Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 20

Instituti i Kosovës për ujëra

1. Me qëllim të zhvillimit dhe përparimit hulumtues dhe projektues, Ministria themelon Institutin e Kosovës për ujëra, si organ i pavarur.

2. Detyrat, përgjegjësitë dhe financimi i Institutit të Kosovës për ujëra, përcaktohen me Statutin për veprimtarinë e Institutit.

Neni 21

Autoriteti i rajonit të pellgjeve lumore

1. Për qëllime të administrimit të ujërave sipas këtij ligji, në territorin e pellgjeve të caktuara me këtë ligj, Kosova trajtohet si një rajon i pellgjeve lumore.

2. Për rajonin, nga paragrafi 1. i këtij neni themelohet Autoriteti i rajonit të pellgjeve lumore, tani e tutje Autoriteti.

3. Selia e Autoritetit është në Prishtinë.

4. Autoriteti i raporton Ministrin.

Neni 22

Detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit

1. Autoriteti kryen punët dhe detyrat e parapara me këtë ligj dhe është i detyruar të:

1.1. mbledh të dhënat e nevojshme për caktimin e burimeve, sasi të dhe vetitë e ujërave ;

1.2. ndërmerr masa të nevojshme për ruajtjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë;

1.3. përpilon vlerësime për secilin pellg;

1.4. siguron menaxhimin me pjesët e pellgut ndërkombëtar, në territorin e Kosovës;

- 1.5. udhëheq dhe mirëmban regjistrin e zonave të mbrojtura ujore;
- 1.6. harton planet për menaxhim e ujërave për pellgun;
- 1.7. përpilon dhe zbaton programin e monitorimit dhe masave;
- 1.8. përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave në pellg;
- 1.9. mbledh, përpunon dhe përkujdeset për të dhënat për vrojtimin e ujërave;
- 1.10. mbledh dhe përpunon të dhënat për regjistrin e objekteve dhe pajisjeve ujore;
- 1.11. themelon, përgatitë dhe përkujdeset për regjistrin e ndotësve në pellg ;
- 1.12. propozon shpronësimin e tokës në të cilën gjenden ujërat nëntokësorë, të nevojshme për furnizim publik;
- 1.13. mbledh mjete financiare nga kompensimet, kontributet, buxheti, grantet;
- 1.14. kryen punët financiare-administrative në pellgun përkatës;
- 1.15. afirmon metodat teknike për ruajtjen e ujërave; dhe
- 1.16. kryen detyra shtesë, të caktuara me akt nënligjor nga Ministria.

KREU IV

Neni 23

Ujërat ndërkufitare të lumenjve

1. Administrimi me ujërat ndërkufitare të lumenjve dhe rrjedhat ndërkombëtare, kryhet në pajtim me këtë ligj dhe në pajtim me marrëveshjet ndërkufitare të ratifikuara nga Republika e Kosovës me shtetet fqinj dhe më gjerë.
2. Të gjithë shfrytëzuesit e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, janë të obliguar që gjatë shkarkimi të ujërave të shfrytëzuara, të mos shkaktojnë veprime të dëmshme në mjedisin rrethues dhe sferat tjera të mjedisit.
3. Autoritetet kompetente në nivel shteti duhet ti koordinojnë planet dhe programin e masave për administrimin dhe menaxhimin e ujërave ndërkombëtare.
4. Pellgjet lumore që mbulon territorin Republikës së Kosovës dhe një apo më shumë prej shteteve kufitare dhe më gjerë përcaktohet si rajon i pellgut ndërkombëtar.

Neni 24

Ndikimet negative të ujërave të Kosovës në shtetet fqinjë

1. Në rastet e rrezikut nga ndotja, si dhe ndotjeve të papritura apo shkarkimeve të ujërave të ndotura ose ndikimeve tjera nga ndonjë lum i cili kalon kufijtë e Republikës së Kosovës, Ministria në bashkëpunim me ministrinë relevante, informon palët, shtetet të cilat rrezikohen nga gjendja e krijuar.
2. Ministria obligohet të identifikojë shkaqet dhe pasojat nga ndotja dhe ndikimet tjera negative. Në afatin sa më të shkurt kohorë të filloj procedurat për ndërmarrjen e masave sanuese, si dhe të filloj procedurat për negociimin dhe harmonizimin e veprimeve me autoritetet kompetente të shteteve në kufij për zbatimin

e masave për minimizimin e rrezikut, si dhe eliminimin e rrezikut në burim të parë nga ku është ardhur ndotja apo efekti tjetër negativ në ujë.

Neni 25 **Ndikimet negative nga shtetet fqinje**

1. Në rastet e çrregullimeve - aksidenteve ose kërcënimit nga ndikimet negative në ujëra nga ndonjëri nga shtetet fqinje, Ministria në bashkëpunim me ministritë relevante është e obliguar që menjëherë të ngreh procedurë për informimin e shtetit fqinj, për situatën e re të krijuar dhe për pasojat.

2. Në rast se shteti fqinj nuk vepron në pajtim me marrëveshjet bilaterale apo marrëveshjet ndërkombëtare për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e ujërave ndërkufitare, Ministria në bashkëpunim me ministritë relevante fillon procedurat në nivelet të organeve kompetente ndërkombëtare, me qëllim që shteti fqinj i cili rrezikon ujërat të obligohet të respektoj marrëveshjet ndërkombëtare.

KREU V **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR SHFRYTËZIMIN E UJËRAVE**

Neni 26 **Regjimi i ujërave**

1. Regjimi i ujërave është tërësia e parametrave të cilët e përcaktojnë gjendjen sasiore dhe cilësore të ujërave.

2. Ndalohet kryerja e të gjitha punëve të cilat shkaktojnë ndryshimin në gjendjen ujqor.

3. Intervenimet me qëllim të përmirësimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së gjendjes së mirë të ujërave, kryhen në pajtim me planet për menaxhim të pellgjeve lumore.

Neni 27 **Shfrytëzimi i ujërave**

1. Shfrytëzimi i ujërave përfshinë aktivitetet e marrjes, nxjerrjes, akumulimit, ndryshimit të drejtimit të rrjedhave sipërfaqësore dhe nëntokësore për:

1.1. konsum nga ana e njeriut, për ujë të pijshëm dhe përgatitjen e ushqimeve, bujqësi, industri, teknologji dhe nevoja tjera;

1.2. prodhimin e energjisë elektrike;

1.3. turizëm dhe rekreacion;

1.4. aktivitetet e dërgimit dhe lëshimit, si dhe veprimet tjera ndaj ujit.

Neni 28 **Përparësitë për shfrytëzimin e ujërave**

1. Nëse ka më tepër se një kërkesë për shfrytëzimin e ujit nga një trup i njëjtë ujqor, për të cilin nuk është dhënë leje për shfrytëzimin e ujit, leja lëshohet sipas këtyre prioriteteve:

1.1. furnizimin të popullatës me ujë të pijshëm, përgatitjen e ushqimit dhe ujë për pije për bagëtinë;

1.2. nevojat e bujqësisë;

- 1.3. nevojat e industrisë dhe për nevoja ekonomike;
- 1.4. nevojat e prodhimit të energjisë elektrike dhe nevojat tjera motorike;
- 1.5. nevojat e sektorit jo konsumues - rekreacion;
- 1.6. nevojat e mbushjes së ujit nëpër shishe- nevoja komerciale.

Neni 29
Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave

1. Ujërat janë në shfrytëzim të përgjithshëm nëse:

- 1.1. shfrytëzohen për nevojat e një amvisërie;
- 1.2. nuk nevojiten objekte dhe pajisje tjera për shfrytëzimin e ujërave;
- 1.3. nuk priset regjim i ujërave dhe e drejta për shfrytëzim të barabartë të ujërave, nga ana e personave të tjerë;
- 1.4. shfrytëzohen për fikjen e zjarrit dhe për marrjen e masave të domosdoshme sanitare dhe masave tjera në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme ose fatkeqësive dhe aktiviteteve tjera me interes publik.

KREU VI
PLANIFIKIMI

Neni 30
Dokumentet themelore të planifikimit

1. Dokumentet themelore për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve ujore në territorin e Republikës së Kosovës, janë:

- 1.1. Strategjia shtetërore për ujëra; dhe,
- 1.2. Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore.

Neni 31
Strategjia Shtetërore për Ujëra

1. Strategjia shtetërore për ujëra, hartohet nga Ministria për një periudhë kohore njëzet (20) vjeçare, me mundësi rishikimi dhe plotësimi çdo pesë (5) vjet.
2. Strategjia shtetërore për ujëra, miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me propozimin e Qeverisë.
3. Strategjia shtetërore për ujëra hartohet në bashkëpunim me organet kompetente të administratës shtetërore; për ekonomi, financa, bujqësi, pylltari, zhvillim rural, tregti, industri, shëndetësi, transport, komunikacion, energji, trashëgimi kulturore, ndërmarrje publike dhe private, shoqëri civile dhe organe tjera nga fusha e mjedisit.

Neni 32
Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore

1. Për secilin pellg lumor, përgatitet Planin për menaxhimin e pellgut lumor.
2. Përgjegjës për përgatitjen e Planit për menaxhimin e pellgjeve lumore është Autoriteti.
3. Planin për menaxhimin e pellgut lumor hartohet për periudhën kohore gjashtë (6) vjeçare.
4. Me propozim të Ministrisë, Qeveria miraton Planin për menaxhimin e pellgut lumor.
5. Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, zbatohen përmes lëshimit të lejeve ujore, koncesionit dhe përmes instrumenteve tjera të përcaktuara me këtë ligj.
6. Organet dhe institucionet që kanë të drejta dhe obligime lidhur me administrimin e ujërave në rrjedhat e lumit, janë të obliguara që të punojnë në pajtim me Planin për menaxhimin e pellgjeve lumore.
7. Përmbajtja e planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore është përcaktuar në Shtojcën 1. të këtij ligji.

Neni 33

Hartimi, revidimi, informimi, konsultimi me publikun për Planin e menaxhimit të pellgjeve lumore

1. Për të siguruar pjesëmarrjen e opinionit në hartimin e planit, do të publikohet dhe do të paraqitet në publik plani për menaxhimin e pellgjeve lumore:
 - 1.1. orari kohor dhe programi i punës për hartimin e planit;
 - 1.2. pasqyra e çështjeve të rëndësishme nga fusha e menaxhimit të ujërave, së paku tre (3) vjet nga periudha që është lëndë e planit;
 - 1.3. ekzemplarë të planit për menaxhimin e pellgut lumor së paku një (1) vit para fillimit të periudhës që është lëndë e planit.
2. Qeveria, me vendim paraqet planin në shqyrtim publik.
3. Vendimi publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës".
4. Shqyrtimin publik e organizon Ministria, për kohëzgjatjen e shqyrtimit publik Ministria është e detyruar të organizoj debat profesional për planin.
5. Ministria është e detyruar të përpilojë procesverbal nga debati publik dhe shqyrtimi profesional si dhe t'ia bashkëngjisë shënimet e stenogramit në shqyrtim.

Neni 34

Programi i Masave

1. Me propozim të Autoritetit, Qeveria e miraton programin e masave, për zbatimin e objektivave, të paraqitura në Strategjinë shtetërore për ujëra dhe Planin për menaxhimin e pellgjeve lumore.
2. Programi i masave të caktuara, nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të përmbajë masat themelore, të nevojshme për arritjen e objektivave që kanë të bëjnë me mbrojtjen, rregullimin dhe shfrytëzimin e ujërave.
3. Masat themelore, sipas paragrafit 2. të këtij neni, duhet të përfshijnë:
 - 3.1. masat që duhet zbatuar për mbrojtjen e ujërave;
 - 3.2. masat e parapara me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të dalura nga ky ligj;
 - 3.3. masat e parapara për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës me ligjet në fuqi;

- 3.4. masat e parapara me aktet mbi peshkimin;
 - 3.5. masat që sigurojnë cilësi të qëndrueshme të ujit për pije; dhe
 - 3.6. masat e parapara për rekreacion dhe larje.
4. Masat të cilat zbatohen për rregullimin e ujërave:
- 4.1. masat e zbatuara për mbrojtjen dhe balancimin e sasisë së ujërave masat e zbatuara për mbrojtjen nga efektet e dëmshme të ujërave masat e zbatuara për mirëmbajtjen e ujërave; dhe përcaktimi i hapësirës për ndërtimin e infrastrukturës ujore;
 - 4.2. Masat e zbatuara për shfrytëzimin e ujërave;
 - 4.3. masat e zbatuara për lejimin e shfrytëzimit të ujërave;
 - 4.4. masat e zbatuara për kompensim të kostos së shfrytëzimit të ujërave; dhe
 - 4.5. masat për afirmimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujërave.
5. Programi i masave gjithashtu, mund të përfshijë masat tjera, për të arritur kushte më të mira të ujërave, kur ato duhet të zbatohen veçanërisht, për aprovimin e marrëveshjeve për reduktimin e ngarkesave të ndotjeve në ujëra, afirmimin dhe shfrytëzimin optimal të ujërave si dhe përgatitjen dhe hulumtimin e çështjeve për mbrojtjen e ujërave.
6. Programi i masave gjithashtu, duhet të përcaktoj prioritetet, për zbatimin e masave të parapara në paragrafin 3. të këtij neni.
7. Në bazë të të dhënave, kur konstatohet se me Strategjinë shtetërore për ujëra dhe Planin për menaxhimin e pellgjeve lumore, nuk mund të arrihen objektivat për trupat individuale të ujërave, Ministria do t'i identifikojë arsyet për këtë, do të hulumtoj, përmirësoj vrojtimin e programit dhe do t'i propozojë Qeverisë nxjerrjen e masave shtesë, përfshirë caktimin e vlerave të përkufizuara.
8. Qeveria duhet të shqyrtojë dhe kur është e domosdoshme, të plotësojë programin e masave, për çdo gjashtë (6) vjet.
9. Qeveria, lidhur me zbatimin e masave, do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës, në çdo dy (2) vjet.

Neni 35 **Programi i Monitorimit të ujërave**

1. Programi i Monitorimit të ujërave hartohet nga Ministria ndërsa miratohet nga Qeveria.
 - 1.1. Programi i monitorimit hartohet për një periudhë dyzet (40) vjeçare me mundësi rishikimi, plotësimi dhe ndryshimi, bazuar në të dhënat e monitorimit.
 - 1.2. Kompetent për zbatimin e monitorimit është IHMK.
 - 1.3. Përgjegjës për monitorimi e sasisë dhe cilësisë së ujërave sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe akumulacione është IHMK.
 - 1.4. Përgjegjës për monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave që përdoren për pije është IKSHP dhe ofruesit e shërbimit të ujit.

Neni 36
Ndërlidhja në mes të Strategjisë dhe Planit për Menaxhimin e Pellgjeve me Strategjitë dhe Planet tjera Sektoriale

1. Planet hapësinore dhe planet sektoriale që mund të kenë ndikim në mbrojtjen, rregullimin dhe shfrytëzimin e ujërave, duhet t'i definojnë zonat e mbrojtura dhe ato të rrezikuara.
2. Hartuesi i planeve hapësinore dhe sektoriale, gjatë hartimit, duhet të ketë parasysh regjimin juridik me të cilin rregullohen shkeljet e hapësirës fizike, në rajonet e caktura nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Hartuesi i planeve hapësinore, në procedurën e përgatitjes së tij, duhet të definojë hapësirën fizike e cila është e lidhur me ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve ujore, të përcaktuar në Strategjinë e Shtetrorë për ujëra dhe Planin për menaxhimin e pellgjeve lumore.

KREU VII

Neni 37
Objektet dhe pajisjet ujore

1. Objektet dhe pajisjet ujore në kuptim të këtij ligji, janë objekte të dedikuara, për:
 - 1.1. përcaktimin e regjimit të ujërave: digat me pajisjet dhe objektet e tyre akumuluese, rezervuarët, basenet e retencionit dhe inundacioneve shtretërit e rregulluar të lumit, rrëqeve të rregulluara dhe sipërfaqeve erozive, kanaleve rrethore, stacioneve të pompimit, mureve mbrojtëse;
 - 1.2. sigurimin, transportin dhe përgatitjen e ujit për furnizimin e banorëve, nevoja industriale dhe nevoja tjera ekonomike dhe komunale;
 - 1.3. sigurimin, sjelljen dhe përgatitjen e ujit për ujitje të tokave bujqësore, pranimin dhe dërgimin e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të tepërta - kullim;
 - 1.4. sjelljen dhe shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike.

Neni 38
Statusi juridik i objekteve dhe pajisjeve ujore

1. Statusi i objekteve dhe pajisjeve ujore fitohet ose humbet në bazë të vendimit të cilën e nxjerr Ministri.
2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk do të lëshohet nëse objektet dhe pajisjet nuk kanë leje përdorimi - ujore, ndërtimore.
3. Statusi i objekteve dhe pajisjeve ujore pushon atëherë kur ato bëhen të panevojshme për interesin publik.

Neni 39
Krijimi i objekteve dhe pajisjeve ujore

1. Objektet dhe pajisjet ujore, në kuptim të këtij ligji, përcaktohet si pronë publike apo pronë e operatorit të shërbimeve publike.

2. Objektet dhe pajisjet ujore mund të përfshihen në transaksione, vetëm në mes të personave nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Kur objekti dhe pajisja ujore është në pronësi publike ose të operatorit të shërbimit publik, sipas këtij ligji, personat tjerë të cilët synojnë përdorimin e objektit dhe pajisjes ujore për destinime, kur një aktivitet i tillë, nuk e cenon ose pengon aktivitetin, për të cilin është ndërtuar objekti dhe pajisja ujore e për të cilën është dhënë leja ujore nga Ministria, mund të marrin pjesë si investitorë.

4. Palët nga paragrafi 3. i këtij neni, janë të detyruara të bëjnë mirëmbajtjen e rregullt dhe investive të objekteve dhe pajisjeve ujore, proporcionalisht me investimet e kryera dhe vëllimit të përdorimit për destinime tjera.

5. Marrëveshjet reciproke lidhur me të drejtat dhe detyrimet për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen në mes të pronarit të objekteve dhe pajisjeve ujore dhe palëve nga paragrafi 4. i këtij neni, do të rregullohen me kontratë.

6. Në rast të falimentimit apo likuidimit të operatorit të shërbimeve publike, objektet dhe pajisjet ujore kalojnë në pronën publike.

Neni 40 **Financimi i ndërtimit të objekteve dhe pajisjeve ujore**

1. Me pëlqimin e Ministrisë, personi i interesuar, mund të marrë pjesë si investitor në ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve ujore të cilën e ndërton ministria, komuna për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave apo qëllime tjera.

2. Personi juridik dhe fizik nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk mund të fitojë të drejtën pronësore në objektet dhe pajisjet ujore.

3. Të drejtat dhe detyrimet në mes të pronarit të objekteve dhe pajisjeve ujore dhe palëve nga paragrafi 1. i këtij neni, rregullohen me kontratë.

Neni 41 **Përdorimi i objekteve dhe pajisjeve ujore**

1. Bartësi i së drejtës ujore, duhet të sigurojë mbrojtjen e objekteve dhe pajisjeve ujore, për mbrojtje kundër efekteve të dëmshme të ujërave, ndërtimin e objekteve të posaçme si dhe t'i menjanojë të gjitha defektet e paraqitura.

2. Me lejen ujore apo koncesionin për ujëra, caktohet detyrimi për vrojtimin e fenomeneve natyrore, lidhur me përdorimin e posaçëm të pronës ujore dhe vlerësimin e ndikimit, të objekteve ose impianteve në regjimin ujor, si dhe mënyra e dërgimit të të dhënave Ministrisë.

3. Bartësi i së drejtës ujore është i detyruar që të ketë rregullat për përdorim dhe mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve ujore.

Neni 42 **Digat dhe akumulimet**

1. Me qëllim të arritjes së sigurisë konstruktive, ekonomike dhe funksionale, digat projektohen, ndërtohen dhe shfrytëzohen sipas dokumentacionit të paraparë teknik, të hartuar në pajtim me aktin nënligjor të cilin e nxjerr Ministria si dhe ligjeve tjera.

2. Personi juridik i cili menaxhon me digën, është i detyruar që një kopje të studimit t'ia dërgojë Ministrisë, më së voni tridhjetë (30) ditë, para fillimit të mbushjes dhe zbrazjes së akumulimit.

Neni 43
Vrojtimi i digave

1. Vrojtimi dhe shfrytëzimi i digave bëhet në pajtim me dokumentacionin teknik dhe kushtet e lejes ujore.
2. Nëse me rastin e vrojtimit konstatohen mangësi të cilat mund të rrezikojnë stabilitetin e digës dhe objekteve përcjellëse, personi juridik i cili menaxhon me digën, është i detyruar që menjëherë ta informojë Ministrinë.
3. Personat fizikë dhe juridikë të cilët vrojtojnë digat, duhet të jenë të licencuar nga organet kompetente për këtë çështje.
4. Personat fizikë dhe juridik detyrohen të raportojnë mbi gjendjen e sigurisë së digave çdo gjashtë (6) muaj, si dhe të marrin masa adekuate për rehabilitimin e digës.

Neni 44
Alarmimi në rast rreziku

1. Personi juridik i cili e menaxhon me digën është i detyruar që:
 - 1.1. ta ruaj projektin për pasojat, në rastet e shkatërrimit të papritur ose të kapërderdhjes së digës;
 - 1.2. të instaloj dhe mirëmbaj pajisjet për lajmërim dhe alarmim;
 - 1.3. të organizoj dhe siguroj lajmërimin dhe alarmimin në rast rreziku; dhe
 - 1.4. ta ndërlihdh sistemin e lajmërimit dhe alarmimit të digës me sistemet e njejta komunale, territoret e të cilave janë potencialisht të rrezikuara në rast të shkatërrimit ose kapërderdhjes së papritur të digës.

KREU VIII
RREGULLIMI DHE KONTROLLIMI I UJËRAVE

Neni 45
Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave

1. Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave përfshin aktivitetet dhe masat për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet, mbrojtjen nga erozioni dhe rrëketë, si dhe menjanimin e pasojave nga veprimet e dëmshme të ujit.
2. Mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave kryhet në kushte, në mënyra dhe në procedura të parapara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 46
Kompetencat për mbrojtje nga vërshimet e dëmshme të ujërave

1. Kompetent për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtjen nga erozioni dhe veprimet tjera të dëmshme në zona urbane, zona e kufijve të qytetit është komuna.
2. Kompetent për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtjen nga erozioni dhe veprimet tjera të dëmshme të ujërave në hapësirën e pellgut lumor është Autoriteti.

3. Komunat dhe Autoriteti janë kompetente edhe për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastruktures mbrojtëse në shtretërit e lumenjve, përfshirë edhe pritrat malore, muret mbrojtëse dhe objektet tjera mbrojtëse.

4. Financimi për rregullim dhe mirëmbajtje bëhet nga buxheti i Kosovës, Ministrisë, Komunave dhe nga burimet tjera.

5. Ministria përcjell koordinimin e aktiviteteve që ndërmerren nga komunat dhe Autoriteti nga paragrafet 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni.

6. Të gjitha aktivitetet dhe masat që ndërmerren në rregullimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen nga ujërat, përfshirë edhe erozionin, janë të obliguara të kryhen në harmoni me Strategjinë shtetërore të ujërave dhe Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, përfshirë edhe planet zhvillimore dhe urbane të komunave.

Neni 47

Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave

1. Programin për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave e hartojnë komunat dhe Autoriteti në bashkëpunim me organet tjera të administratës shtetërore, kompetente për kryerjen e punëve nga fusha e ujërave.

2. Ministria me akt nënligjor përcakton përmbajtjen, mënyrën dhe procedurat e programit.

Neni 48

Mbrojtja e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulimeve

1. Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar:

1.1. ndërrimi i drejtimit të ujit në ujërrjedha dhe kanale;

1.2. nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hudhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujërrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre;

1.3. ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;

1.4. kryerja e punëve në afërsi të ujërrjedhave, liqeneve, akumulimeve, tuneleve të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre, si dhe transportimin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme;

2. Ndërrimi i drejtimit, nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, ndërtimi i objekteve kryhet vetëm nën kushtet, mënyrën dhe procedurat e caktuara sipas këtij ligji.

3. Kushtet, kriteret dhe procedurat përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 49

Kompetent për mbrojtjen ujërrjedhave dhe objekteve ujore

1. Kompetent për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore, janë:

1.1. brenda zonave urbane, komunat;

1.2. brenda kufirit të rajonit të pellgjeve lumore, Autoriteti.

1.3. Ministria përcjell dhe mbikëqyrë punët dhe aktivitetet e ndërmarra për mbrojtjen e brigjeve të ujë rrjedhave dhe akumulimeve.

Neni 50 Monitorimi i plotave

1. Vija e plotave përcaktohet nga Ministria, në bazë të dhënave zyrtare nga IHMK.
2. Autoriteti detyrohet të përcjellë dhe vrojtojë fenomenet dhe dukuritë ujore dhe të paralajmrojë Ministrinë në afat kohor prej pesëmbdhjetë (15) minuta.
3. Ministria është e detyruar që para shpalljes së rregullt dhe të jashtëzakonshme të mbrojtjes nga përmytjet, gjatë dhe pas mbrojtjes së rregullt nga përmytjet, ta përcjellë dhe vrojtojë gjendjen e nivelit të ujit, të saktësojë valën përmytëse si dhe të jep prognoza afatshkurte dhe afatgjate për reshjet.

Neni 51 Mbrojtja nga erozioni dhe rregullimi i rrëkeve

1. Kompetent për përcaktimin e kufirit të zonave eroziv dhe zonave të rrezikuar nga erozioni është Ministria.
2. Kompetent për përcaktimin e zonave erozive brenda zonave urbane është komuna, ndërsa kufijt dhe rajonet erozive brenda pellgut lumor, kompetent është Autoriteti.
3. Komuna dhe Autoriteti përcaktojnë masat dhe punët për mbrojtjen e zonave erozive dhe rregullimin e rrëkeve në bazë të dokumentacionit teknik dhe në përputhje me planet për menaxhimin e pellgjeve lumore.
4. Financimi për mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrëkeve dhe aktivitetëve për mbrojtje nga erozioni kryhet nga Ministria, komuna dhe Autoriteti.
5. Mjetet sigurohen nga të hyrat e Buxhetit të Kosovës dhe të hyrat vetanake.
6. Ministria përcjell koordinimin e aktivitetëve që ndërmirren nga komunat dhe Autoriteti nga paragrafet 1, 2 dhe 3. të këtij neni.

Neni 52 Masat për mbrojtjen e zonave erozive

1. Masat për mbrojtjen e zonave eroziv në kuptim të këtij ligji janë:
 - 1.1. Ndalimi i nxjerrjes së dheut, rërës, zhavorrit dhe gurit;
 - 1.2. Ndalimi i shartimit, prerjes dhe gërmimit të drunjve dhe kaçubave;
 - 1.3. Ndalimi i kullotjes së kafshëve;
 - 1.4. Pyllëzimi, mbjellja e barit dhe brezimi me kanale, ngritja e murit.
2. Prerja e drujve mund të bëhet në kushte, në mënyra dhe procedura me të cilat sigurohet mbrojtja nga erozioni, si dhe në harmoni me Ligjin për pyjet.
3. Kriteret, mënyrat dhe procedurat përcaktohen me vendim nga organet kompetente.

Neni 53 Krijimi i erozionit dhe kompensimi i dëmit

Personat fizikë dhe juridikë të cilët me veprimet e tyre jo të drejta në sipërfaqet punuese ose me veprimet tjera shkaktojnë erozion me çka u bëjnë dëm pasurive të personave tjerë fizikë dhe juridikë, përfshirë edhe objektet tjera, janë të detyruar që në llogari të tyre të ndërmarrin masa për mbrojtje dhe pengimin e erozionit, dhe menjanimin e pasojave të dëmeve dhe t'i kompensojnë dëmet e shkaktuara.

Neni 54 Shpallja e zonës erozive

1. Në rajonet në të cilat erozioni dhe rrëketë kanë intenzitet dhe vëllim të tillë që sjellin pasoja të dëmshme në ujërrjedha, tokë, objekte dhe paluejtshmëri të tjera, me vendim të Ministria shpallen zona erozive.
2. Përrjashtimisht, nga paragrafi 1. i këtij neni, Qeveria mund të shpall zonë erozive një zonë, kur është e nevojshme mbrojtja e objekteve të mëdha ekonomike, të komunikacionit si dhe objekteve tjera, më rëndësi publike.
3. Në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh, nga dita e shpalljes së zonës erozive, Qeveria, me propozim të Ministrisë, me akt nënligjor, përcakton masat dhe veprimet për mbrojtje nga erozioni.
4. Në rajonet e shpallura si zona erozive, mund të ndërtohen objekte investive edhe nëse gjatë punimeve të ndërtimit, ndërrohen zonat kadastrale, pasi të jenë plotësuar kërkesat dhe kushtet e parapara nga ky ligj.
5. Në pellgjet e liqeneve natyrale, akumulimeve artificiale apo në rajonet ku është paraparë ndërtimi i akumulimeve, duhet paralelisht me punimet e ndërtimit, të ndërmerren masa dhe veprime edhe kundër erozionit.

Neni 55 Rrëketë - Rregullimi i rrëkeve

1. Me rregullimin e rrëkesë bëhet edhe rregullimi i sipërfaqeve erozive në pellg.
2. Me dokumentacionin teknik për rregullimin e rrëkesë përcaktohen brigjet dhe brezi i shtratit të rrëkesë nga vendgrumbullimi deri te vendi i shkarkimit në lum apo mjedis tjetër.
3. Me objektet për rregullimin e rrëkesë menaxhon komuna në zonat urbane dhe Autoriteti.
4. Komunat dhe Autoriteti janë të detyruara t'i ndërmarrin të gjitha masat për rregullimin e rrëkeve në zonat urbane dhe pellgjet lumore.
5. Personat juridikë dhe fizikë të cilët me veprimet e tyre shkatërrojnë objektet për rregullimin e rrëkeve, janë të detyruar që me mjete të veta t'i kompensojnë ato, apo t'i kthejnë në gjendje të mëparshme.

Neni 56 Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave me nxjerrjen e inerteve nga shtretërit dhe brigjet e trupave uJOR sipërfaqësorë

1. Me qëllim të mbrojtjes së regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit, nxjerrin inertet - rëra, zhavorri dhe gurët, nga trupat uJOR sipërfaqësor në segmente të caktuara.
2. Përcaktimi i segmenteve ku mund të nxirret rëra, zhavorri dhe gurët, bëhet në harmoni me Strategjinë shtetërore të ujit dhe Planin për menaxhimin e pellgut lumor.
3. Deri me aprovimin e Strategjisë shtetërore të ujit dhe Planit për menaxhimin e pellgut lumor, kjo çështje zgjidhet me vendim nga Ministria.

4. Nxjerja e rërës, zhavorrit dhe gurëve nga trupi uJOR sipërfaqësorë, kryhet në kushtet, mënyrën dhe procedurën sipas lejes uJore.

Neni 57
Njoftimet dhe detyrimet

1. Komunat dhe Autoriteti janë të detyruara ta njoftojnë Ministrinë në afat sa më të shkurtër kohor me rastin e rrezikut nga erozioni dhe rrëketë.

2. Ministria detyrohet që menjëherë ta njoftojë popullatën e prekur nga rreziku dhe siguron informata adekuate për masat e marra dhe këshillon çfarë masash të ndërmerren me qëllim që të mbrohet jeta, shëndeti dhe pasuria e njerëzve.

KREU IX
MBROJTJA E UJËRAVE

Neni 58
Klasifikimi i trupave uJorë sipërfaqësorë

1. Më qëllim të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së uJërave, trupat e uJërave sipërfaqësorë trajtohen në aspektin ekologjik dhe kimik.

2. Ministri, me akt nënligjor, do të bëjë klasifikimin e trupave uJorë sipërfaqësorë.

3. Parametrat e gjendjes ekologjike dhe kimike, nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet të përcaktohen më dispozitat mbi mbrojtjen e mjedisit.

Neni 59
Klasifikimi i trupave uJorë nëntokësorë

1. Më qëllim të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së uJërave, trupat e uJërave nëntokësorë duhet të klasifikohen në klasa, në pajtim me gjendjen sasiore dhe kimike.

2. Parametrat e gjendjes sasiore dhe kimike, nga paragrafi 1. i këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor mbi mbrojtjen e mjedisit.

3. Ministri, me akt nënligjor, do t'i klasifikojë trupat uJorë nëntokësorë.

Neni 60
Lëshimi i uJërave të ndotura

1. Ndalohet, përveç me leje uJore, shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe uJërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat uJorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në brigjet buzë lumit dhe tokave të lagëta.

2. Ministria me akt nënligjor do të përcaktojë kushtet, mënyrat parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të uJërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në mjedisin pritës.

Neni 61
Ndalimi i plehërimit dhe përdorimit të preparateve kimike

Në zonat vërshuese ndalohet përdorimi i substancave organike dhe inorganike për plehërimin e tokës, spërkatjen e pemëve dhe mbrojtjen e bimëve pranë lumenjve, akumulimeve dhe brigjeve lumore, në largësi prej tridhjetë (30) metrash.

Neni 62
Ndalimi i larjes së mjeteve motorike

Ndalohet larja e mjeteve lundruese, mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësore dhe në brigje.

Neni 63
Hudhja e substancave dhe mbeturinave

1. Ndalohet hudhja e substancave dhe mbeturinave të ngurta, të lëngëta dhe të gazëta të cilat për shkak të vetive fizike, kimike dhe biologjike, rrezikojnë shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, florën dhe faunën ujore, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë objektet dhe pajisjet ujore.

2. Ndalohet çfardo lloj i transportimit të substancave, materieve dhe mbeturinave të rrezikshme pranë akumulimeve dhe zonave ujore të mbrojtura përveç me leje të veçantë.

3. Ndalohet çfardo lloj ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve të dedikuara për prodhimin e substancave dhe materieve të rrezikshme në afërsi të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, përfshirë edhe akumulimet.

Neni 64
Detyrimet e personave

1. Personat juridikë dhe fizikë të cilët shkarkojnë, hedhin, depozitojnë substanca të rrezikshme dhe të dëmshme në ujëra, në brigje apo në zona të mbrojtura, janë të detyruar që të raportojnë rastin tek autoritetet kompetente.

2. Personat juridikë dhe fizikë të cilët shkaktojnë pasoja me veprimet e tyre nga paragrafi 1. i këtij neni, janë të detyruar që me shpenzime të veta t'i kompenzojnë dëmet e bëra personave tjerë dhe resurseve ujore.

Neni 65
Prurja e pranueshme ekologjike

1. Prurja e pranueshme ekologjike paraqet prurjen minimale e cila siguron ekuilibrin natyror dhe ekosistemit lidhur me ujin.

2. Prurja e pranueshme ekologjike përcaktohet në bazë të punëve hulumtuese.

3. Deri në fuqizimin e rregullores nga paragrafi 4. i këtij neni, prurja e pranueshme ekologjike përcaktohet në bazë të karakteristikave hidrologjike, hidraulike, habitateve për sezone karakteristike sipas metodave të avancuara standarde, si dhe sigurisë së nëntëdhjetë e pesë për qind (95%) të prurjes së mesatares mujore.

4. Ministri me akt të veçantë nënligjor nxjerr rregulloren mbi mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike.

5. Rregullorja përmban metodologjinë dhe hulumtimet e nevojshme, duke marrë parasysh specifikat e ekosistemit lokal dhe variacionet sezonale dhe procedurat e përcaktimit të kësaj prurje.

6. Shpenzimet e hulumtimeve të nevojshme i bartë investitori respektivisht shfrytëzuesi.

Neni 66
Zonat e mbrojtura ujore

1. Me qëllim të mbrojtjes së resurseve ujore Zonat e mbrojtura ujore janë :

- 1.1. zonat e mbrojtura sanitare;
- 1.2. zonat e mbrojtura për qëllime strategjike; dhe,
- 1.3. zonat e mbrojtura ekologjike (Natura 2000).

2. Ministria përkatëse për mjedis, me akt nënligjor, në bashkëpunim me autoritetin kompetent për shëndetësi, përcaktonë kriteret për zonat e mbrojtura sanitare.

3. Ministria përkatëse për mjedis, me akt nënligjor, në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme dhe Ministrinë e shëndetësisë përcakton kriteret për zonat e mbrojtura për qëllime strategjike.

4. Zonat e mbrojtura ujore ekologjike, zona të përcaktuara më Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

5. Zonat e mbrojtura ujore shpallen nga Qeveria, me propozim të Ministrisë përkatëse për mjedis.

Neni 67
Mbrojtja e regjimit ujqor

Kur mund të rrezikohen kushtet cilësore apo sasiore, në zonën e mbrojtur ujore, mund të ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve apo poseduesve të tokës.

Neni 68
Zona për larje

1. Ministria kompetente për shëndetësi do të bëjë vrojtimin e cilësisë së ujërave për larje.

2. Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë, Komunitat dhe Kompanitë e ofrimit të shërbimeve të ujit, me akt nënligjor cakton zonat për larje.

KREU X
FITIMI I SË DREJTËS UJORE

Neni 69
E drejta për ujë

1. E drejta për ujë të pijshëm është e drejtë elementare dhe e pa cenuar.

2. Ndarja dhe realizimi i së drejtës për ujë, nuk guxon të shpie në pasoja negative për resurset ujore.

3. E drejta për ujë realizohet në kushte, mënyra dhe procedura të parapara me këtë ligj.

Neni 70
Fitimi dhe kushtet e fitimit të së drejtës ujore

1. Fitimi i së drejtës ujore, sigurohet:

- 1.1. me leje ujore;
- 1.2. me koncesion.
2. Bartësi i të drejtës ujore shfrytëzon ujin sipas kriterëve të përcaktuara me aktin për fitimin e së drejtës ujore.
3. Koncesioni, përkatësisht partneriteti publik dhe privat kryhet në kushte, mënyra dhe procedura për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujërave të caktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 71 **Procedurat për lëshimin e lejes ujore**

1. Procedura për fitimin e lejes ujore është:
 - 1.1. Kushtet ujore;
 - 1.2. Pëlqimi ujqor;
 - 1.3. Leja ujore.
 - 1.4. Urdhëresa Ujqore
2. Procedura për kushtet ujore, pëlqim ujqor, leje ujore dhe urdhëresë ujore do të rregullohet me akt nënligjqor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 72 **Leja ujore**

1. Leja ujore lëshohet për:
 - 1.1. nxjerrje të ujqit për konsum të përgjithshëm;
 - 1.2. shkarkim të ujërave të ndotura;
 - 1.3. ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqor;
 - 1.4. aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave;
 - 1.5. për hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave;
 - 1.6. eksploatimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit;
 - 1.7. përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale; dhe
 - 1.8. aktivitete tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor.
2. Leja ujore nuk është e nevojshme për: shfrytëzimin e puseve, burimeve, cisternave dhe objekteve të ngjajshme për furnizimin e një amvisërie me ujë të pijshëm, fikjen e zjarreve dhe ndërmarrjen e masave urgjente sanitare dhe masave tjera në rast të rrezikut të përgjithshëm.
3. Me Lejen Ujqore përcaktohet destinimi, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të ujqit, shkarkimi i ujërave të ndotura, regjimi i punës së objekteve dhe impianteve, deponimi i mbeturinave të ngurta dhe të lëngëta si dhe kushtet tjera.
4. Leja Ujqore, sipas këtij ligji, për shfrytëzimin e ujërave ndërkufitare dhe shkarkimin e ujërave të ndotura në ujërat ndërkufitare jepet në pajtim me marrëveshjen ose konventën ndërkombëtare.

5. E drejta e shfrytëzimit ose shkarkimit të ujërave të ndotura, e fituar në bazë të lejës ujore, nuk mund të bartet në persona tjerë, pa pëlqimin e autoritetit kompetent.

6. Ministria lëshon lejet ujore me akt nënligjor, Ministria mund të delegojë kompetenca për të cilat komunat dhe Autoriteti, mund të lëshojnë leje ujore.

7. Leja Ujore rishqytohet së paku në çdo pesë (5) vjet.

8. Bartësi i të drejtës ujore, detyrohet t'a informojë lëshuesin e lejës, në rast të ndryshimit në veprim, teknologji dhe shfrytëzim të ujit apo në raste tjera, kur mund të kenë ndikim të rëndësishëm në regjimin ujqor.

Neni 73 Kohëzgjatja e lejes ujore

1. Leja ujore lëshohet me afat kohor të caktuar, varësisht nga lloji i objektit dhe pajisjeve si dhe qëllimit të shfrytëzimit të ujit, por jo më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, përveç lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujqorë sipërfaqësorë, që lëshohet me kohëzgjatje vetëm një (1) vit, me mundësi vazhdimi varësisht nga prurjet e aluvionit në trupin ujqor.

2. Në rastin e dhënies së lejes ujore për nevoja energjetike afati i lejes mund të jetë deri në dyzet (40) vjet.

3. Kohëzgjatja e lejes ujore fillon nga momenti i fillimit të veprimit juridik të lejes ujore.

Neni 74 Bartësi i së drejtës ujore

Bartësi i së drejtës për ujë mund të jetë secili person juridik dhe fizik i regjistruar në Kosovë, përfshirë edhe organet e pushtetit, në kushte, në mënyra dhe procedura të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të dalura nga ky ligj.

Neni 75 Detyrimet e bartësit të drejtës ujore

1. Bartësi i lejës për shfrytëzimin e ujit dhe shkarkimin e ujërave, hedhjen e mbeturinave të ngurta, lëngëta dhe të gazëta, substancave dhe materieve të rrezikëshme, është i detyruar të bëjë; matjet e sasisë së ujit të shfrytëzuar, ujërave të shkarkuara si dhe matjet e mbeturinave të ngurta, lëngëta dhe të gazëta, substancave dhe materieve të rrezikëshme të hudhura në trupat ujqorë në kushte, në mënyra dhe procedura të caktuara me leje ujore.

2. Bartësi i lejës ujore është i detyruar të instalojë dhe të mirëmbajë pajisjet për matjen e detyrimeve sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Bartësi i lejës ujore është i detyruar në çdo kohë t'u lejojë qasje personave të autorizuar, nga autoriteti kompetent që ka lëshuar lejen ujore.

Neni 76 Ndërprerja e lejës ujore

1. E drejta e fituar me lejen ujore, ndërpritet:

1.1. në çdo moment kur autoriteti kompetent për lëshuarjen e lejes ujore konstaton rrezikimin e kërkesave për ujë të pijshëm, raste emergjente, vitet e thatësisë, prishjen e regjimit ujqor në trupat ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë;

1.2. me heqjen dorë të bartësit të lejës;

1.3. për shkak të pushimit të veprimtarisë, për të cilën është lëshuar leja ujore;

1.4. kur për një periudhë mbi një (1) vjeçare nuk shfrytëzohet e drejta për leje ujore;

1.5. me revokim, nga ana e lëshuesit të lejës, për shkak të mosrespektimit të kushteve të lejës ujore.

2. Në rastet, kur mungesa e ujit rrezikon në atë masë nevojat e shfrytëzuesve të ujit të pijëshem, në rajonin e caktuar, ndërptiten lejet ujore; për përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike, hardha të peshkut, ambalazhim të ujit, ujitje të tokave bujqësore.

Neni 77

Procedura e marrjes dhe pushimit të Lejes Ujore

Ministri me akt nënligjor, do të përcaktojë më hollësisht: procedurën, përmbajtjen, formën, kushtet, mënyrën, ruajtjen dhe çështjet tjera me rëndësi, lidhur me dhënjen dhe humbjen e të drejtës së lejës ujore.

Neni 78

Veprimtaritë për të cilat ndahet koncesioni për shfrytëzimin e ujërave

1. Veprimtaritë afariste të cilat realizohen me shfrytëzimin e ujit nga trupat ujqorë sipërfaqësor dhe nëntokësorë, realizohen përmes ndarjes së koncesionit, në pajtim me ligjin.

2. Koncesionin mund ta fitojë personi juridik dhe fizik dhe secili biznes që është i regjistruar në Kosovë.

3. Koncesioni ipet nga Ministria dhe ndahet për:

3.1. shfrytëzimin e ujit për sistemet e ujitjes;

3.2. shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike;

3.3. shfrytëzimin e ujit për nevoja teknologjike;

3.4. shfrytëzimin e ujërave minerale dhe termale;

3.5. mbushjen e ujit në shishe për nevoja komerciale;

3.6. kultivimin e peshqve dhe shpezëve ujqorë;

3.7. ofrimin e shërbimeve turistike, sportive dhe shërbimeve tjera rekreative me ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve të përhershme.

4. Koncesioni nuk mund të ndahet, kur me të rrezikohet furnizimi me ujë të pijshëm, bilanci i prodhimit të ushqimit dhe bilancet tjera ekonomike.

5. Lidhur me procedurat për ndarjen e koncesionit si dhe çështjet tjera lidhur me koncesionin, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga ky ligj, përfshirë aktin nënligjor për leje ujore dhe legjisllacionin në fuqi për koncesion.

6. Mjetet e realizuara nga ndarja e koncesionit derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Neni 79

Ndarja e koncesionit përmes konkursit publik

Koncesioni ndahet përmes konkursit publik të organizuar dhe realizuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjisllacionit në fuqi.

Neni 80
Kompenzimi dhe ndërprerja e koncesionit

Kompenzimi dhe ndërprerja e koncesionit rregullohet me Ligjin nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat.

KREU XI
SISTEMI INFORMATIV DHE PJESEMARRJA E PUBLIKUT

Neni 81
Sistemi Informativ ujq

1. Sistemi Informativ Ujq përfshinë masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me regjistrimin, transferimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e të dhënave si dhe çështjet e tjera me rëndësi për administrim me ujëra.
2. Sistemi informativ ujq përfshin të dhënat për:
 - 2.1. sasinë dhe cilësinë e ujërave;
 - 2.2. protokollin ujq dhe kadastrat e sistemit ujq;
 - 2.3. protokollin e të gjitha lejeve;
 - 2.4. regjistrin e substancave të shkarkuara nga bartësi i lejes ujq;
 - 2.5. masat për rehabilitimin dhe programet për mbrojtjen e ujërave;
 - 2.6. incidentet e dëmtimit të ujërave dhe aksidentet mjedisore;
 - 2.7. regjistrin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme, në resurset ujq;
 - 2.8. aktivitetet që janë të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin;
 - 2.9. analizat e ndikimeve të materieve të rrezikshme; dhe
 - 2.10. regjistrin më të dhënat e ndërtimeve, instalimeve apo deponive ekzistuese që janë të rrezikshme;
 - 2.11. raportim për gjendjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.
3. Të gjithë personat dhe institucionet, janë të detyruara të ofrojnë të dhëna për ujërat Ministrisë dhe autoriteteve kompetente për ujëra.
4. Të dhënat e Sistemit informativ ujq janë publike dhe çdo kush mund të ketë qajse në to, përveç të dhënave që konsiderohen sekret shtetëror.
5. Ministria, me akt nënligjq, përcakton më hollësisht punën, mënyrën dhe çështjet tjera me rëndësi për sistemin informativ ujq.

Neni 82
Protokollin ujq

1. Protokollin uhor është evidencë zyrtare e lejeve dhe koncesioneve të lëshuara.
2. Protokollin uhor është i përhershëm dhe përmban regjistrin e dokumentacionit teknik.
3. Protokollin uhor e mbajnë autoritetet kompetente për lëshuarjen e lejeve dhe koncesioneve ujore.
4. Kopjet e lejeve ujore i dergohen sistemit informativ uhor dhe Autoritetit, për regjistrim në bazën e të dhënave.

Neni 83 Kadastrin uhor

1. Kadastrin uhor përmban: të dhënat topografike, hidrografike, hidrologjike, hidrogjeologjike, teknike dhe ekonomike si dhe të dhënat tjera mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave dhe të dhënat teknike për objektet dhe impiantet e sistemit uhor.
2. Autoriteti mbanë kadastra uhorë për:
 - 2.1. trupat uhorë sipërfaqësorë;
 - 2.2. trupat uhorë nëntokësorë;
 - 2.3. shfrytëzuesit, ndotësit e ujërave dhe vendet e shkarkimit të ujërave;
 - 2.4. zonat erozive dhe të ujë rrjedhave rrëke;
 - 2.5. objektet e sistemit uhor të cilët janë në pronësi publike;
 - 2.6. pronën publike ujore; dhe
 - 2.7. objektet dhe impiantet për furnizim publik me ujë të pijes.
3. Të gjithë personat juridikë dhe fizikë, qeveritarë e joqeveritarë të cilët posedojnë të dhëna të tjera të cilat regjistrohen në katastrin uhor nga paragrafi 2. i këtij neni, duhet pa kompensim t'ua dërgojnë të dhënat Autoritetit për regjistrim.

Neni 84 Pjesëmarrja e publikut

1. Hartuesi i Strategjisë shtetërore të ujërave dhe Planit për menaxhimin e pellgut lumor, do ta vë në diskutim publik planin para finalizimit.
2. Propozuesit e Strategjisë dhe Planit e informojnë publikun një vit (1), para fillimit të periudhës së hartimit.
3. Propozuesit sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në hartimin dhe miratimin e strategjisë dhe planit.
4. Para fillimit të hartimit të Strategjisë shtetërore të ujërave dhe Planit për menaxhimin e pellgjeve lumore, propozuesi i njofton autoritet e pushtetit qendror dhe lokal, organizatat joqeveritare, bartësit e të drejtës ujore dhe personat tjerë të interesuar, me përmbajtjen e propozimit.
5. Në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, propozuesi siguron bashkëpunimin e publikut dhe duhet ta informojë publikun me raport, për avancimet në hartim, një (1) vit, para fillimit të periudhës për të cilën nxirret Strategjia shtetërore e ujërave dhe Planit për menaxhimin e Pellgjeve lumore.

6. Propozuesi, duhet të shpallë Strategjinë shtetore të ujërave dhe Planin për menaxhimin e pellgjeve lumore së paku një (1) vit, para fillimit të periudhës, për të cilën nxirret Strategjia shtetore e ujërave dhe Plani për menaxhimin e pellgjeve lumore.

7. Personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi 4. i këtij neni, mund të paraqesin vërejtje në planin, në afat prej dy (2) muajsh, nga dita e publikimit.

8. Me kërkesë të personave juridikë dhe fizikë, Strategjia shtetore e ujërave dhe Plani për menaxhimin e pellgjeve lumore rishqyrtohen çdo pesë (5) vjet.

9. Ndryshimet dhe plotësimet bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë për miratimin e tij.

10. Publikut i sigurohet pjesëmarrja në procedurat e dhënies së lejes ujore dhe koncesionit të cilat rregullohen me aktin nënligjor për lejen ujore.

KREU XII FINANCIMI

Neni 85 Burimet financiare

1. Mjetet financiare për administrimin, menaxhimin dhe zhvillimin e ujërave sigurohen nga :

- 1.1. pagesa për shfrytëzimin e ujërave;
- 1.2. pagesa për shkarkimin e ujërave;
- 1.3. pagesa për nxjerrjen e materialeve inerte;
- 1.4. buxheti i Kosovës;
- 1.5. komunat;
- 1.6. donacionet dhe grantet; dhe
- 1.7. burimet tjera financiare, në pajtim me ligjin.

Neni 86 Pagesa për shfrytëzimin, shkarkimin në ujëra dhe nxjerrjen e materialeve inerte

1. Detyruesi për pagimin e kompensimit për shfrytëzimin e ujit janë personat juridikë dhe fizikë, të cilët në bazë të lejes për shfrytëzimin e ujërave, shkarkimin, shfrytëzimin e inerteve dhe koncesion, paguajnë në pajtim me këtë ligj:

- 1.1. nxjerrin, akumulojnë, depozitojnë, zënë, thithin ose i shfrytëzojnë në mënyrë tjetër ujërat, trupat natyror ose artificial për furnizim me ujë për:
 - 1.1.1. konsum të njeriut, përmes sistemit të furnizimit publik,
 - 1.1.2. prodhim të artikujve ushqimor,
 - 1.1.3. nevoja të mbrojtjes,
 - 1.1.4. bagëti,

- 1.1.5. ujitjen e tokave bujqësore;
- 1.1.6. nevojat industriale dhe teknologjike;
- 1.1.7. prodhimin e energjisë ekeletrike,
- 1.1.8. ambalazhimin e ujit, për nevoja komerciale;
- 1.1.9. rritjen e peshkut;
- 1.1.10. kullimin e tokave;
- 1.1.11. shpërlarjen e inerteve dhe
- 1.1.12. aktivitetet tjera të cilat ndikojnë nëregjimin uJOR ose në morfologjinë e trupit uJOR.

2. Detyruesit për pagesën e kompensimit për shkarkimin e ujërave te ndotura janë personat juridikë dhe fizikë që kryejnë aktivitetet në bazë të lejës për shkarkimin e ujërave të ndotura, të dhënë në pajtim me këtë ligj;

3. Detyruesit për pagesë të kompensimit për nxjerjen e rërës, zhavorrit dhe gurit janë përona juridikë dhe fizikë që kryejne aktivitetet në bazë të lejës për shfrytëzim nga shtrati dhe brigjet e trupave uJorë sipërfaqësorë, të dhënë në pajtim me këtë ligj;

Neni 87

Rastet për të cilat nuk paguhet për shfrytëzimin e ujërave

1. Për shfrytëzimin e ujërave nuk paguhet, në rast se uji përdoret për:

1.1. shtimin e ujërave nëntokësorë dhe

1.2. mbrojtjen e mjedisit.

2. Pagesa për nxjerrjen e materialeve inerte nuk paguhet kur rëra, zhavorri dhe guri përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtje.

Neni 88

Detyrimi për pagesat uJore

1. Detyrimi për pagesës së ujit krijohen në ditën kur leja krijon pasoja juridike.

2. Personi i cili siguron shërbimet për furnizim me ujë palës së tretë, ka detyrim për të gjitha pagesat që rrjedhin nga shfrytëzimi i ujit për këtë qëllim.

Neni 89

Destinimi i mjeteve nga pagesat

1. Mjetet nga neni 85 i këtij ligji, do të shfrytëzohen për administrim, menaxhim dhe zhvillim të resurseve uJore.

2. Pagesat që rrjedhin nga ky ligj, nuk do të përdoren për qëllime administrative apo në vend të buxhetit.

3. Pagesat të cilat paguhen sipas nenit 85 të këtij ligji, shfrytëzohen për mirëmbajtjen e ujë rrjedhave, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve, për rregullimin e ujë rrjedhave dhe mbrojtjen nga efektet e dëmshme të ujërave.

Neni 90
Realizimi i mjeteve nga pagesat

1. Pagesat nga neni 86 të këtij ligji, paguhen në llogari të Buxhetit të Kosovës, në mënyrë dhe kushte të cilat përcaktohen me leje ujore.
2. Ministria, për çdo vit i dërgon Qeverisë raportin financiar për realizimin e mjeteve nga pagesat.

Neni 91
Përcaktimi i lartësisë së pagesës për shfytëzimin e ujërave

1. Qeveria, me akt nënligjor do të themeloj strukturën e pagesave të ujit, në pajtim me këtë ligj.
2. Akti nga paragrafi 1. i këtij neni, do të ketë për bazë parimet, „ndotësi paguan” dhe „shfrytëzuesi paguan”.

Neni 92
Buxheti

1. Mjetet për administrim, menaxhim dhe zhvillim të resurseve ujore parashihen me Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe komunave.
2. Mjetet nga paragrafi 1. i këtij neni, shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve dhe masave të parapara me dokumentet e planeve dhe programeve, të nxjerrura në pajtim me këtë ligj.

KREU XIII

Neni 93
Zbatimi i ligjit

Zbatimin e këtij ligji dhe akteve tjera nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, e bënë Ministria.

Neni 94
Mbikëqyrja inspektuese

1. Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji i kryejnë Inspektorët e ujërave të Ministrisë dhe inspektorët e autorizuar të ujërave të komunave.
2. Inspektori i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivel të Kosovës, ndërsa inspektori i autorizuar i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivele komunale.

Neni 95
Prezantimi i Inspektorit

1. Inspektori i ujërave, përkatësisht inspektori i autorizuar i ujërave është person zyrtar, i cili është i pavarur në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese. Identitetin dhe autorizimin e vet e dëshmon me legjitimacion dhe emblemë. Legjitimacionin e lëshon dhe sekuestron organi që e ka lëshuar.
2. Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit dhe emblemës sipas paragrafit 1. të këtij neni, si dhe mënyrën e lëshimit dhe sekuestrimit të saj e përcakton Ministri me akt nënligjor.

Neni 96
Caktimi i Inspektorit

1. Inspektor i ujërave caktohet personi me arsimim superior inxhinier i Ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknikë, me së paku pesë (5) vjet përvojë pune në profesion.
2. Inspektor i autorizuar i ujërave caktohet personi me arsimim superior, inxhinier i Ndërtimtarisë - drejtimi i Hidroteknikës, me më së paku tre (3) vjet përvojë pune në profesion.

Neni 97
Fushëveprimi i Inspektorit të ujërave dhe inspektorit të autorizuar të ujërave

1. Inspektori i ujërave dhe inspektori i autorizuar i ujërave në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjetëra, ka të drejtë, të:

- 1.1. kontrollojë dhe të konstatojë nëse shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave realizohet në përputhje me këtë ligj;
- 1.2. kontrollojë dhe të konstatojë nëse me truallin rreth bregut veprohet në përputhje me këtë ligj;
- 1.3. kontrollojë dhe të konstatojë nëse personat juridikë që menaxhojnë me pellgjet ujore kanë hartuar programe për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave;
- 1.4. kontrollojë dhe të konstatojë nëse personat juridikë që menaxhojnë me pellgjet ujore i ndërmarrin masat dhe aktivitetet e nevojshme për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave;
- 1.5. kontrollimin e gjendjes së ujërrjedhave dhe ujërave ndërkombëtar;
- 1.6. ushtrojnë mbikëqyrjen e aplikimit të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji dhe realizimit të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës;
- 1.7. kontrollojë të gjitha punët e sistemit ujqor, ndërtimit të objekteve dhe të gjitha punëve të cilat mund të shkaktojnë ndryshime cilësore dhe sasiore në regjimin ujqor;
- 1.8. kontrollojnë zbatimin e kushteve të lejes ujqore;
- 1.9. vrojtojnë dhe kontrollojnë planet e menaxhimit të pellgut lumor;
- 1.10. kontrollojë realizimin e planeve dhe programeve të Autoritetit,
- 1.11. kontrollojë mënyrën e shfrytëzimit të objekteve dhe impianteve;
- 1.12. kontrollojë rezultatet e matjeve, sasisë dhe cilësisë së ujërave të përdorura dhe ujërave të ndotura, si dhe materialeve të nxjerra nga ujë rrjedhat;
- 1.13. kontrollojë funksionimin dhe rregullsinë e impianteve për pastrimin e ujërave;
- 1.14. kontrollojë rregullsinë e veprimit të objekteve mbrojtëse ujqore dhe objekteve për shfrytëzimin e ujërave;
- 1.15. kontrollojë rregullsinë e pajisjeve për përcaktimin e sasisë së ujërave të përdorura dhe ujërave të ndotura të shkarkuara;

1.16. kontrolloje pajisjet për matje të ujërave të ndotura dhe inerteve të shfrytëzuara nga ujë rrjedhat;

1.17. kontrollojë regjimin e mbushjes dhe zbrazjes së akumulimeve nëse kryhet në pajtim me normat ndërkombëtare, përkatësisht me lejet ujore, se a është lënë hapësira e nevojshme në akumulim për pranimin e plotës në periudha të caktuara dhe a kryhen vrojtimet e digave dhe objekteve tjera të sistemit ujq;

1.18. kontrollojë dhe konstatojë shfrytëzimin e pasurive ujore publike në pajtim me këtë ligj;

1.19. konfiskojë përkohësisht materialet inerte të nxjerra nga ujërrjedhat ose drunj të prerë nga brezat pyjore mbrojtëse si dhe mjeteve me të cilat janë nxjerrë inertet nga ujë rrjedhat gjatë transportimit të tyre;

1.20. ndërmerr edhe masa tjera me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji;

1.21. Inspektori i ujërave është i autorizuar të hyjë në çdo objekt apo ndërmarrje kur ka dyshim të bazuar se janë shkelur dispozitat e këtij ligji.

2. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit, Inspektori i ujërave dhe inspektori i autorizuar i ujërave me aktvendim, mundet të:

2.1. urdhërojë shmangien e mangësive të konstatuara gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe të caktoj afat për shmangien e tyre;

2.2. urdhërojë ndërmarrjen e masave me qëllim të mbrojtjes nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat dhe nga ujërat, mbrojtje nga erozioni dhe rrëketë;

2.3. urdhërojë ndërprerjen e ndërtimit të objekteve dhe impianteve për të cilat nevojite leje ujore, nëse objektet e tilla ndërtohen pa leje ujore apo objekti ndërtohet në kundërshtim me kushtet e parapara në lejen ujore;

2.4. ndalojë shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave, nxjerrjen e rërës, zhavorit dhe gurit, hapjen e puseve si dhe aktivitetet dhe veprimtaritë tjera, të cilat ndikojnë mbi regjimin e ujërave apo mbi morfologjinë e trupit ujq, nëse veprimtaritë dhe aktivitetet kryhen pa leje apo në kundërshtim me lejen;

2.5. urdhërojë ndërprerjen e përkohshme ose të përhershme të të gjitha veprimeve që janë në kundërshtim me këtë ligj, apo me ndonjë akt të përgjithshëm dhe të urdhërojë kthimin në gjendje të mëparshme;

2.6. njoftojë organet kompetente të pellgjeve ujore dhe organet tjera të administratës për parregullsitë e konstatuara dhe të kërkojë intervenim nga të njëjtat;

2.7. ndalojë vazhdimin e aktiviteteve që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe aty ku ka nevojë shmangien e të njëjtave, të urdhërojë që të bëhen matje që do të bien mbi kurrizin e përgjegjësit të aktivitetit ose veprimtarisë dhe përkohësisht të sekuestrojë sendet me të cilat kryhet aktiviteti ose veprimtaria;

2.8. urdhërojë ndërmarrjen e masave dhe të aktiviteteve me qëllim të evitimit të mangësive të konstatuara.

3. Kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, inspektori i ujërave i raporton Ministrisë me shkrim për parregullsitë dhe mungesat dhe me aktvendim do t'i caktojë masat dhe afatet për eliminimin e tyre.

4. Inspektori për ujëra dhe inspektori i autorizuar i ujërave duhet ta informojë policinë kur dyshon se është kryer vepër penale në pasuritë ujore.

5. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të kërkojë praninë e personit zyrtar të autorizuar nga organi i administratës shtetërore.

Neni 98

Detyrimet e personave juridikë dhe fizikë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes

Me qëllim të realizimit të mbikëqyrjes inspektuese, personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar që inspektorit kompetent t'i mundësojnë qasje në lokalet dhe në dokumentacionin e personit juridik dhe fizik, t'ia dorëzojë të dhënat e kërkuara, sqarimet dhe lajmërimet, të bëjë matjet të marrë ekzemplarë dhe të grumbullojë prova në përputhje me këtë ligj.

Neni 99

Aktvendimet, urdhrat dhe masat tjera

Inspektori kompetent sipas këtij ligji është i pavarur në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, merr aktvendime dhe ndërmer masa të tjera në suazat e të drejtave, detyrimeve dhe autorizimeve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 100

Aktvendimi i inspektorit

1. Në bazë të gjendjes së konstatuar inspektori i ujërave, inspektori i autorizuar i ujërave, do të përpilojë procesverbal në të cilin futen konstatimet për gjendjen dhe masat e propozuara në bazë të së cilit nxjerr aktvendime me të cilat ngarkohen personat juridikë dhe që të ndermirren masa, në përputhje me këtë ligj.

2. Kundër aktvendimit të Inspektorit të ujërave, inspektorit të autorizuar të ujërave, mund të paraqitet ankesë në Ministri brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

3. Ankesa i parashtrohet Komisionit të pavarur për ankesa nga fusha e ujërave në kuadër të ministrisë, i cili formohet nga Ministri i cili duhet të vendosë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës.

4. Kundër vendimit të shkallës së dytë, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrij padi për konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

5. Ankesa e paraqitur kundër aktvendimit të inspektorit të ujërave, inspektorit të autorizuar të ujërave nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në aktvendim.

Neni 101

Përmbajtja e aktvendimit

1. Aktvendimi i inspektorit të ujërave, inspektorit të autorizuar të ujërave, veçanërisht duhet të përmbaj:

1.1. numrin dhe datën e nxjerrjes së aktvendimit;

1.2. shenjën nga libri i inspektorit të ujërave, inspektorit të autorizuar të ujërave;

1.3. përshkrimin e gjendjes së konstatuar dhe kategorizimin e ndërtimit, përkatësisht të pjesës së objektit apo impiantit i cili nuk ndërtohet në bazë të lejes për ujera, të projektit dhe aktvendimit për kushtet e lokacionit;

1.4. numrin, datën dhe organin i cili e ka lëshuar lejen ujore për ndërtim, nëse si e tillë është lëshuar;

1.5. të dhënat përshkruese dhe hapësinore për truallin në të cilin ndërtohet me theksimin e bazës juridike me të cilin rregullohen marrëdhëniet në mes pronarit të tokës, realizuesit dhe investitorit;

1.6. afatin dhe udhëzimin për mënjanimin e parregullsive;

1.7. përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve për mënjanimin e ndërtimit, përkatësisht pjesëve të cilat ndërtohen pa leje dhe përcaktimin e gjobave për çdo vonesë;

1.8. arsyetimin; dhe

1.9. këshillën juridike dhe të dhënat tjera në pajtim me ligjin.

Neni 102 Ekzekutimi i Aktvendimit

1. Procedura për ekzekutimin e aktvendimit fillon me dorëzimin e aktvendimit palës me të cilin lejohet ekzekutimi i tij.

2. Ekzekutimin administrativ të aktvendimit e zbaton inspektori i ujërave, inspektori i autorizuar i ujërave, në pajtim me këtë ligj dhe ligjisllacioni në fuqi.

3. Nëse investuesi nuk vepron sipas aktvendimit nga neni 100 i këtij ligji, aktvendimin e ekzekuton inspektori i ujërave, ndërsa për inspektimet lokale të nivelit komunal, aktvendimin e ekzekutojnë organet komunale.

Neni 103 Shpenzimet e ekzekutimit

1. Shpenzimet e ekzekutimit të aktvendimit të inspektorit të ujërave, sigurohen nga Ministria, ndërsa të inspektorit të autorizuar të ujërave nga buxheti i komunave, deri në arkëtimin nga ekzekutuesi.

2. Shpenzimet për ekzekutimin e aktvendimit nga paragrafi 1. i këtij neni, kompensohen nga investitori në pajtim me ligjin dhe nuk mund të jenë më të larta nga shpenzimet reale.

Neni 104 Mbikqyrja e veprimeve të Inspektorit i autorizuar të ujërave

1. Nëse inspektori i ujërave vërteton se inspektori i autorizuar i ujërave nuk i kryen punët për të cilat është i autorizuar në pajtim me këtë ligj, është i detyruar menjëherë të dërgojë propozimin në formë të shkruar te kryetari i komunës për ndërmarrjen e masave në emër dhe për llogari të komunës.

2. Kryerjen e punëve të marra nga inspektori i autorizuar i ujërave, inspektori i ujërave i kryen deri në realizimin e tyre.

3. Për punët e kryera sipas paragrafit 2. të këtij neni, inspektori i ujërave e njofton organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e financave.

Neni 105 Mbikëqyrja e akteve administrative të inspektorit të autorizuar të ujërave

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e ujërave, sipas këtij ligji vërtetojnë se aktet administrative të lëshuara në bazë të këtij ligji janë në kundërshtim me këtë ligj, janë të detyruar të dërgojnë propozim në formë të shkruar me procesverbal për gjendjen e konstatuar për anulimin e akteve të tilla administrative deri te organi kompetent i shkallës së dytë.

Neni 106
Mbikëqyrja ndaj ligjshmërisë së punës të organeve komunale

Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës të organeve komunale e kryen ministria, për punët nga kompetenca e tyre.

Neni 107
Mbikëqyrjet mbi ligjshmërinë së organeve komunale

1. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë e punës së organeve komunale, Ministria i kryen punët si vijon:

1.1. përcjell ligjshmërinë e punës së organeve të komunës dhe merr masa, aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës që kanë të bëjnë me ujërat;

1.2. ua tërheq vërejtjen organeve të komunës, për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj, të cilat janë të interesit publik me rëndësi lokale;

1.3. vë në dukje mangësitë materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunës, të cilat do ta pamundësonin kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, që janë të interesit publik me rëndësi lokale;

1.4. rekomandon për zbatimin e drejtpërdrejtë të kompetencave të komunës, për punët që duhet t'i kryejnë në pajtim me këtë ligj, e me kërkesë të organeve të komunës;

1.5. përcjell nxjerrjen me kohë të akteve të komunave, të përcaktuara me këtë ligj;

1.6. paraqet iniciativa dhe propozime te organet komunale, nëse konstaton mos zbatimin e këtij ligji si rezultat - pasojë të ndeshjes së interesave ndërmjet tyre;

1.7. përcjell ligjshmërinë e aktvendimeve që i miratojnë organet e komunës në zgjedhjen e punëve administrative për të drejtat, detyrimet dhe interesat e personit fizik dhe juridik, të miratuara në bazë të këtij ligji dhe merr masa në pajtim me ligjin;

1.8. me kërkesë të organeve të komunës, jep mendim dhe ndihmë profesionale për propozim aktet që dalin nga ky ligj; dhe,

1.9. përcjellë realizimin e transparencës në punën e organeve të komunës, veçanërisht nga aspekti i njoftimit të rregullt, me kohë, të mirëfilltë dhe të plotë të qytetarëve për punët e përcaktuara me këtë ligj.

2. Për masat e ndërmarra nga paragrafi 1. i këtij neni, Ministria informon organet e komunës.

3. Pas udhëzimeve dhe masave e aktiviteteve të marra, organet e komunës duhet të sigurojnë kryerjen e punëve sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 108
Anulimi i aktvendimit të së drejtës ujore

Nëse në rastin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese të cilin e bënë inspektori i ujërave vërtetohet se me aktvendimin për dhënjën e lejes ujore, të cilat janë të plotëfuqishme në procedurë administrative, e në

mënyrë të dukshme janë shkelur dispozitat materiale të këtij ligji, i propozon Ministrit që ta anulojë një aktvendim të tillë, sipas të drejtës së mbikëqyrjes.

KREU XIV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 109

1. Çdo objekt dhe pajisje ujore që ka qenë i administruar nga ndërmarrjet e regjistruara si ndërmarrje hidroekonomike në organin kompetent, do të kalojnë në administrimin e Ministrisë.
2. I gjithë dokumentacioni dhe pasuria që ka qenë e administruar nga ish Enti për Hidroekonomi dhe Instituti për Hidroekonomi, Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit të Ekonomisë ujore të Kosovës, do të kalojnë në administrim të Ministrisë.
3. Pasuria, të drejtat dhe detyrimet e personave juridik, kalojnë në Ministri.
4. Ministria nga buxheti ekzistues merr përsipër implementimin e këtij ligji me stafin aktual, kurse stafi plotësues të kompletohen pas vitit 2014 pasi të krijohen kushtet për punësim të ri.

Neni 110

1. Çdo Person që ushtron veprimtari në pasuritë ujore, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, duhet që brenda afatit prej gjashtë (6) muaj, t'i parashtrij kërkesë Ministrisë, për fitimin e lejës ujore.
2. Qeveria, me propozim të Ministrisë, brenda afatit prej gjashtë (6) muaj, duhet të publikoj listën e objekteve dhe pajisjeve ujore.
3. Të gjitha sipërfaqet e tokës dhe objekteve dhe pajisjeve ujore e përcaktuar si pronë ujore, duhet të regjistrohen si pronë publike, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) muaj, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.
4. Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore duhet të nxjerren në afat prej njëzetekatër (24) muaj.
5. Të gjitha veprimtaritë ujore, të të gjithë personave juridik dhe fizik, harmonizohen me kushtet dhe procedurat sipas këtij ligji, në afat prej tetëmbëdhjet (18) muaj.
6. Komunat, do t'i harmonizojnë të gjitha aktivitetet e të tyre më këtë ligj, në afat prej dymbëdhjetë (12) muaj, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.
7. Harmonizimi i të gjitha planeve hapësinore dhe planeve sektoriale, me planet për administrimin me ujëra, do të bëhet brenda afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj.
8. Të gjitha aktet nënligjore, të dalura nga ky ligj, do të nxirren mbrenda afatit, prej tetëmbëdhjetë (18) muaj.

KREU XV DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 111

1. Të gjithë personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo dispozitat e nxjerra nga ky ligj, do të konsiderohen si kundërvajtje dhe do të gjobitet prej pesëmijë (5000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
2. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 10, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëmijë (5000 €) deri në dhjetë mijë (10.000 €), ndërsa personi juridik prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në tridhjetë mijë (30.000 €) euro.
3. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 11, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në njëzet mijë (20.000 €) euro, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
4. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 42 të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në tridhjetë mijë (30.000 €) euro, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në tetëdhjetë mijë (80.000 €) euro.
5. Personi juridik i cili vepron në kundërshtim me nenin 43, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
6. Personi juridik i cili vepron në kundërshtim me nenin 44, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
7. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 47, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në dyzet mijë (40.000 €) , ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
8. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji, do të gjobitet prej pesë mijë (5.000 €) deri në dhjetë mijë (10.000 €) euro, ndërsa personi juridik prej dhjetë mijë (10.000 €) deri tridhjetë mijë (30.000 €) euro.
9. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji, do të gjobitet prej pesë mijë (5.000 €) deri në njëzet mijë (20.000 €), ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
10. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 61, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në dyzet mijë (40.000 €), ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
11. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 62, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëmijë (5.000 €) deri në 30.000 €, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në shtatëdhjetë mijë (70.000 €) euro.
12. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 63, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në pesëdhjetë mijë (50.000) ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
13. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 64, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në 30.000 €, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
14. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 69, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në tridhjetë mijë (30.000 €), ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000€) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
15. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 72, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në pesëdhjetë mijë (50.000) ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.

16. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 86, të këtij ligji, do të gjobitet prej njëmijë (1000 €) deri në dhjetë mijë (10.000 €) euro , ndërsa personi juridik prej tridhjetë mijë (30.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.

Neni 112
Dispozitat Shfuqizuese

1. Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji për Ujërat e Kosovës nr. 2004/24 - Rregullorja e UNMIK-ut nr 2004/41. Ky Ligj do të zëvendësojë çdo dispozitë të ligjeve në fuqi që nuk është në përputhshmëri me të.

1. Pjesë përbërse e këtij ligji është edhe Shtojca 1.

Neni 113
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-147
19 mars 2013

Shpallur me dekretin Nr.DL-011-2013, datë 05.04.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.

LIGJI Nr. 04/L-147 PËR UJRAT E KOSOVËS

SHTOJCA 1

PLANET E MENAXHIMIT TË BASENEVE LUMORE

A. Planet e menaxhimit të basenit lumor duhet të mbulojnë elementët e mëposhtme:

1. një përshkrim të përgjithshëm të karakteristikave të rajonit të pellgut ujor ku përfshihen:

1.1. ujërat sipërfaqësore:

- skicimin e vendndodhjes dhe kufijve të zonave ujore;
- skicimin e ekorajoneve dhe tipeve të zonës së ujit sipërfaqësorë brenda basenit të lumit;
- identifikim i kushteve të referencës për sipërfaqen e tipeve të zonave të ujërave sipërfaqësore.

1.2. ujërat nëntokësore:

- skicimin e vendndodhjes dhe kufijve të zonave të ujit nëntokësor;

2. një përmbledhje të presioneve dhe ndikimit të aktivitetit njerëzor mbi statusin e ujit sipërfaqësor dhe ujit nëntokësor, duke përfshirë:

- vlerësimin e ndotjes së pikës burimore;
- vlerësimin e ndotjes së burimit të shpërndarë, duke përfshirë dhe një përmbledhje të përdorimit të tokës;
- vlerësimin e presioneve mbi statusin cilësor të ujit, duke përfshirë dhe nxjerrjen;
- analizimin e ndikimeve të tjera të aktivitetit njerëzor mbi statusin e ujit.

3. identifikimi i hartave të zonave të mbrojtura, ashtu siç kërkohet e direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

4. një hartë të rrjeteve të monitorimit siç kërkohet e direktiva kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

5. një prezantim në formën e harte rezultatesh të monitorimit të programeve të realizuara sipas atyre dispozitave për statusin e:

5.1. ujit sipërfaqësor (ekologjik dhe kimik);

5.2. ujit nëntokësor (kimik dhe cilësor);

5.3. zonat e mbrojtura;

6. një listë e objektivave mjedisore të përcaktuara siç kërkohet në direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

7. për ujin sipërfaqësor, ujërat nëntokësore dhe zonat e mbrojtura, duke përfshirë një identifikim të veçantë të rasteve siç kërkohet në direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian.

8. dhe informacioni shoqëruar i kërkuar po nga ai nen;

9. një përmbledhje të analizës ekonomike të përdorimit të ujit, ashtu siç kërkohet në direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10. një përmbledhje e programit ose programeve të masave ashtu siç e kërkon direktiva kornizë e ujërave 2000/60 e Bashkimit Evropian;

10.1. një përmbledhje e masave të ndërmarra për të plotësuar kërkesa e direktivës kornizë të ujërave 2000/60 e Bashkimit Evropian;

10.2. një raport i hapave praktike dhe masave të marra për të aplikuar parimin e mbulimit të kostove të përdorimit të ujit në përputhje me direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.3. një përmbledhje e masave të marra për të plotësuar kërkesat e direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.4. një përmbledhje e kontrolleve për nxjerrjen dhe pompimin e ujit, duke përfshirë dhe referencën që i bëhet regjistrave dhe identifikimit të rasteve në të cilat janë bërë përjashtime sipas direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.5. një përmbledhje e kontrolleve të bëra për shkarkimeve/derdhjeve të burimit me një pikë dhe aktivitete të tjera që kanë ndikim mbi statusin e ujit, në përputhje me parashikimet e direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.6. një identifikim të rasteve në të cilat shkarkimet direkt në ujin nëntokësor janë të autorizuar në përputhje me dispozitat e direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.7. një përmbledhje e masave të ndërmarra në përputhje me direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.8. një përmbledhje e masave të marra për të parandaluar ose ulur ndikimin e incidenteve aksidentale të ndotjes;

10.9. një përmbledhje e masave të marra për zonat e ujit të cilat ka të ngjarë të mos arrijnë objektivat sipas kërkesave të direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.10. detaje të masave të marra për të shmangur rritjen e ndotjes së ujit të marinës në përputhje me direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.11. detaje të masave të ndërmarra për të shmangur rritjen e ndotjes në ujërat e marinës, në përputhje me direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

10.12. një regjistër i programeve të tjera më të detajuara dhe i planeve të menaxhimit për rrethet e baseneve lumore që merren me nën-basene, sektorë, çështje ose tipe uji të veçanta, s'bashkua me një përmbledhje të përmbajtjeve të tyre;

11. një përmbledhje e informacionit publik dhe e masave këshilluese të marra, rezultatet e tyre dhe ndryshimet e planit të bërë si rezultat;

11.1. një listë e autoriteteve kompetente në përputhje me direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;

11.2. pikat e kontaktit dhe procedurat për marrjen e dokumentacionit dhe informacionit veçanërisht detajet të masave të kontrollit të miratuara në përputhje me direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian dhe të të dhënave aktuale të monitorimit të mbledhura;

B. Përditësimi i parë si dhe përditësimet e tjera të planit të menaxhimit të basenit lumor duhet të përmbledhin gjithashtu dhe:

1. një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve ose përditësimeve që prej kohës së botimit të versionit të mëparshëm të planit të menaxhimit të basenit lumor, duke përfshirë dhe një përmbledhje të rishikimeve që do të realizohen sipas direktivës kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian;
2. një vlerësim i progresit të bërë drejt arritjes së objektivave mjedisore, duke përfshirë prezantimin e rezultatit të monitorimeve për periudhën e planit të mëparshëm në formën e hartës, dhe një shpjegim për çdo objektiv mjedisor që nuk është realizuar;
3. një përmbledhje dhe një shpjegim i masave të parashikuara në versionet e mëparshme të planit të menaxhimit të basenit ujor, të cilat nuk janë realizuar;
4. një përmbledhje e masave shtesë të brendshme të miratuara sipas direktivën kornizë të ujërave 2000/60 të Bashkimit Evropian, që prej kohës së botimit të versionit të mëparshëm të planit të menaxhimit të basenit lumor.